

# PËRMBUSHJA E OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË KOSOVË

Perspektiva e  
Shoqërisë Civile



Autor: INDEP

Edituar nga: Ekipi i INDEP

Programi: Zhvillimi i Qëndrueshëm

Publikuar: Dhjetor 2022

Dizajni: KUKU Creative



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, përfaqësojnë opinionin e autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

---

## Përmbajtja

<i>HYRJE</i> .....	6
<i>Të Arriturat Kryesore në Udhëtimin e Kosovës drejt Agjendës 2030</i> .....	10
<i>Dokumentet Strategjike të Kosovës për Zhvillim të Qëndrueshëm</i> .....	11
<i>METODOLOGJIA</i> .....	13
<i>Përmbushja e OZhQ-ve në Kosovë</i> .....	14
<i>OZHQ 1: PA VARFËRI</i> .....	14
Vlerësimi i targeteve.....	14
Situata e përgjithshme.....	14
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë.....	15
Sfidat kryesore.....	16
Hapat e ardhshëm.....	16
<i>OZHQ 2: ZERO URI</i> .....	17
Vlerësimi i targeteve.....	17
Situata e përgjithshme.....	17
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë.....	18
Sfidat kryesore.....	19
Hapat e ardhshëm.....	19
<i>OZHQ 3: SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE</i> .....	20
Vlerësimi i targeteve.....	20
Situata e përgjithshme.....	20
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë.....	22
Sfidat kryesore.....	22
Hapat e ardhshëm.....	22
<i>OZHQ 4: ARSIM CILËSOR</i> .....	24
Vlerësimi i targeteve.....	24
Situata e përgjithshme.....	24
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë.....	26
Hapat e ardhshëm.....	26
<i>OZHQ 5: BARAZI GJINORE</i> .....	28
Vlerësimi i targeteve.....	28

Situata e përgjithshme.....	28
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë .....	30
Sfidat kryesore .....	30
Hapat e ardhshëm .....	30
<i>OZHQ 6: UJË I PASTËR DHE KANALIZIME.....</i>	<i>32</i>
Vlerësimi i targeteve.....	32
Situata e përgjithshme.....	32
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë .....	33
Sfidat kryesore .....	33
Hapat e ardhshëm .....	34
<i>OZHQ 7: ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR.....</i>	<i>35</i>
Vlerësimi i targeteve.....	35
Situata e përgjithshme.....	35
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë .....	37
Sfidat kryesore .....	37
Hapat e ardhshëm .....	38
<i>OZHQ 8: PUNË DINJITOZE DHE RRITJE EKONOMIKE.....</i>	<i>39</i>
Vlerësimi i targeteve.....	39
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë .....	42
Sfidat kryesore .....	42
Hapat e ardhshëm .....	42
<i>OZHQ 9: INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË.....</i>	<i>43</i>
Vlerësimi i targeteve.....	43
Situata e përgjithshme.....	43
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë .....	44
Sfidat kryesore .....	44
Hapat e ardhshëm .....	45
<i>OZHQ 10: ZVOGËLIM I PABARAZIVE.....</i>	<i>46</i>
Vlerësimi i targeteve.....	46
Situata e përgjithshme.....	46
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë .....	48

Sfidat kryesore .....	48
Hapat e ardhshëm .....	48
<i>OZHQ 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME .....</i>	<i>50</i>
Vlerësimi i targeteve.....	50
Situata e përgjithshme.....	50
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë .....	52
Sfidat kryesore .....	52
Hapat e ardhshëm .....	53
<i>OZHQ 12: KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM.....</i>	<i>54</i>
Vlerësimi i targeteve.....	54
Situata e përgjithshme.....	54
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë .....	55
Sfidat kryesore .....	55
Hapat e ardhshëm .....	56
<i>OZHQ 13: VEPRIM PËR KLIMËN.....</i>	<i>57</i>
Vlerësimi i targeteve.....	57
Situata e përgjithshme.....	57
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë .....	58
Sfidat kryesore .....	58
Hapat e ardhshëm .....	59
<i>OZHQ 15: JETA NË TOKË.....</i>	<i>60</i>
Vlerësimi i targeteve.....	60
Situata e përgjithshme.....	60
Ligjet që përfshijnë këtë objektivë .....	62
Sfidat kryesore .....	62
Hapat e ardhshëm .....	62
<i>OZHQ 16: PAQE, DREJTËSI DHE INSTITUCIONE TË FORTA .....</i>	<i>63</i>
Vlerësimi i targeteve.....	63
Situata e përgjithshme.....	63
Ligjet që përfshijnë këtë qëllim.....	65
Sfidat kryesore .....	65

Hapat e ardhshëm .....	65
<i>OZHQ 17: PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT.....</i>	<i>66</i>
Vlerësimi i targeteve.....	66
Situata e përgjithshme.....	66
Sfidat kryesore .....	67
Hapat e ardhshëm .....	68
<i>Harta e Aktorëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm.....</i>	<i>69</i>

## HYRJJE

**Kosova** është shteti më i vogël i Ballkanit Perëndimor, i cili ndan kufij me Shqipërinë në perëndim, me Malin e Zi në veriperëndim, me Serbinë në veri dhe lindje dhe me Republikën e Maqedonisë së Veriut në jug. Ekonomia në Kosovë është ekonomi tranzitore, ekonomi e cila gjatë viteve 2017-2019 ka tejkaluar vendet tjera të Ballkanit Perëndimor me rritje të BPV-së reale, duke shënuar një normë mesatare prej 4.3%. Edhe pse me sipërfaqe të vogël Kosova gëzon biodiversitet të pasur i cili është rezultat i ndërveprimit kompleks të gjeologjisë dhe hidrologjisë duke krijuar një shumëllojshmëri të gjerë të kushteve të habitatit për rritjen e florës dhe zhvillimin e faunës.

Republika e Kosovës shpalli pavarësinë e saj në vitin 2008 dhe deri tani është njohur zyrtarisht nga 117 shtete nga e gjithë bota. Kosova është shtëpi për rreth 1.78<sup>1</sup> milion banorë të cilët shumica janë shqiptarë, një pjesë e konsiderueshme serb, duke vazhduar me turq, egjiptian, rom, ashkali dhe goran. Me shpalljen e pavarësisë, Kosova është bërë anëtare e institucioneve ndërkombëtare si e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, mirëpo jo e Kombeve të Bashkuara.



Në shtator të vitit 2015, OKB-ja miratoi Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Kjo agjendë paraqet një plan të veprimit për njerëzit, planetin dhe prosperitetin. 17 objektivat dhe 169 indikatorët e kësaj agjende adresojnë sfidat më të mëdha globale me të cilat përballemi në mijëvjeqarin e fundit, duke përfshirë varfërinë, pabarazinë, ndryshimet klimatike, degradimin e mjedisit, paqen dhe drejtësinë. Adaptimi i kësaj

<sup>1</sup> Vlerësimi i popullsisë 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës, <https://ask.rks-gov.net/media/6623/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>

agjende në politikat shtetërore përpilohet në baza vullnetare, por që është e pritshme që shtetet të ndërmarrin masa për zbatim të saj, përfshirë ndërtimin e mekanizmave të raportimit dhe të përcjelljes së progresit duke përfshirë kornizën e OZHQ-ve në kuadrin e politikave të nivelit qendror dhe lokal.

Si për vendet në zhvillim e sipër, si dhe ato të zhvilluara, investimi në një zhvillim të qëndrueshëm është esencial në mënyrë që të sigurohet prosperitet dhe mirëqenie për gjenerata e tanishme dhe ato që do të vijnë në të ardhmen. Në rastin e Kosovës, si një shtet në zhvillim dhe kandidat potencial që aspirojnë të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian (BE), zhvillimi dhe implementimi i politikave zhvillimore që mbështesin një zhvillim të qëndrueshëm luajnë rol të rëndësishëm. Një ndër agjendat ndërkombëtare që mbështet këtë tranzicion zhvillimor është edhe Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, e cila shërben si udhërrëfyes për të gjitha vendet drejt arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha sferat, si në atë ekonomik, social dhe mjedisor.

Në vitin 2016, Qeveria e Republikës së Kosovës publikoi Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit (SKZH) 2016-2021<sup>2</sup>, e cila do të përcaktonte rrugën e zhvillimit në një periudhë 5 vjeçare. Fatkeqësisht, kjo SKZH nuk adreson ose përfshin kriteret e Agjendës 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) në përgjithësi. Periudha kohore e kësaj strategjie veçse ka mbaruar dhe Kosova akoma nuk ka një raport ndërkombëtar të monitorimit të OZHQ-ve. Kjo tregon se përpjekjet e Kosovës në drejtim të implementimit të Agjendës 2030 lënë shumë për të dëshiruar.

Në maj të vitit 2022 Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës ka publikuar Draftin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit 2022 – 2030. Sipas këtij drafti ka progres në përfshirjen e OZHQ-ve në mënyrë më konkrete në katër shtyllat e kësaj strategjie. Te zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, fokus kryesor i strategjisë në kuptimin e agjendës së gjelbër është zhvillimi i industrisë drejt një ekonomie qarkore. Në aspektin e zhvillimit të barabartë njerëzor, synohet zhvillimi i mekanizmave për uljen e varfërisë dhe rritjen e pasurisë së përgjithshme të popullsisë në mënyrë të qëndrueshme duke përmirësuar cilësinë e jetës. Në kuadër të Drejtësisë efektive dhe Qeverisjes së mirë, në fokus kryesor janë instrumentet qeverisëse në interes të publikut, duke përfaqësuar njëkohësisht interesin e bizneseve dhe të sektorit privat. Mbetet të shihet, se sa këto shtylla do të merren parasysh në vitet në vazhdim gjatë politikë bërjes dhe zhvillimit të vendit në përgjithësi.


Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) ose e BE-së, integrimi i Agjendës 2030 do t'i ndihmonte asaj në procesin e integritimit sa më të shpejtë në këto dy organizata, duke qenë se Agjenda 2030 është një prioritet i pakompromis në strategjitë e tyre. Së pari është e nevojshme krijimi i një kornize strategjike apo plani të veprimit me fokus specifik në OZHQ. Ky plan do të duhej të përfshinte hapa konkret drejt implementimit të OZHQ-ve, si dhe rishikimin e politikave dhe rihartimin e tyre në frymë të Agjendës 2030. Një lehtësim i hartimit të një kornize të

---

<sup>2</sup> Zyra e Kryeministrit. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH). (Janar 2016). E qasshme në: [https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia\\_Kombetare\\_per\\_Zhvillim\\_2016-2021\\_Shqip.pdf](https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf)



tillë është korniza globale e treguesve nga Agjencia dhe Grupi i Ekspertëve mbi Treguesit e OZHQ-ve (IAEA-SDG) të hartuara në bashkëpunim me Komisionin Statistikor të Kombeve të Bashkuara. Bazuar në këtë kornizë, vendet duhet të hartojnë raporte monitoruese vjetore për të treguar rezultatet e arritura kundrejt Agjendës 2030. Kosova duke mos qenë e obliguar të përpiloj një raport vullnetar kombëtar vlerësues për zbatim të OZHQ-ve, ky punim synon të vlerësoj përmbushjen e OZHQ-ve në vitin 2021 dhe do të pasqyrojë progresin e arritur të Kosovës karshi Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve në përgjithësi.



Zhvillimi i qëndrueshëm kërkon integrim të politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore në legjislacionin e vendit. Këto 3 aspekte kanë qenë të përfshira në SKZH 2016-2021, ndonëse nuk janë paraqitur në mënyrë eksplicite. Kurse shtyllat e Draftit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit 2022 – 2030 kanë qëllime zhvillimore të caktuara ku për secilin qëllim ekzistojnë objektiva strategjike të ndërlidhura me OZHQ-të përkatëse.



Ky raport është i ndarë në 2 pjesë. Pjesa e parë përfshinë një hartëzim të akterëve kryesor të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë dhe rolin e tyre në implementimin e Agjendës 2030. Këtu përfshihen edhe dokumentet kryesore të politikave publike të cilat në mënyrë eksplicite kanë adresuar zhvillimin e qëndrueshëm. Pjesa e dytë e raportit përmban një analizë të të dhënave statistikore që ka për synim të vlerësoj konkretisht se sa është implementuar secila nga OZHQ-të në Kosovë deri në vitin 2022. Kjo pjesë ka pasur sfidat e veta, duke pas parasysh mungesën e theksuar të të dhënave të përditësuara të cilat janë të lidhura me indikatorët e OZHQ-ve. Qëllimi kryesor i këtij raporti është që të inkurajoj institucionet të përpilojnë një kornizë të qartë të politikave që i përshtatet pozitës zhvillimore të Kosovës.

## Të Arriturat Kryesore në Udhëtimin e Kosovës drejt Agjendës 2030

Më poshtë janë të listuara ngjarjet kryesore në rrugëtimin e Kosovës drejtë përmbushjes së OZHQ-ve:



- Në vitin 2009 ka filluar zbatimi i Sistemit të Performancës së Komunave, i cili ka pasur për qëllim monitorimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga ana e komunave<sup>3</sup>,
- Në janar të vitit 2016 Zyra e Kryeministrit publikoi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, e cila synonte adresimin e faktorëve që ndikojnë në përmirësimin e standardeve të jetesës<sup>4</sup>,
- Në janar të vitit 2018 Kuvendi i Kosovës miratoi Rezolutën për OZHQ-të, ku Kosova u zotua se do të angazhohet për ta zbatuar kornizën e Agjendës 2030 nëpërmjet miratimit të legjislacionit<sup>5</sup>,
- Në vitin 2018 në faqen e internetit të Kuvendit është shtuar një segment për

<sup>3</sup> Ministria e Pushtetit Lokal, "Sistemi për menaxhimin e performancës së komunave – matje për t'u përmirësuar Versioni i ndryshuar dhe plotësuar 2020". (2020) E qasshme në: <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/05/Dokumenti-Kryesor-i-Sistemit-te-Menaxhimit-te-Performances-Komunale-designed-18.02.2021.pdf>

<sup>4</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, "Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021". (2016) E qasshme në: [https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia\\_Kombetare\\_per\\_Zhvillim\\_2016-2021\\_Shqip.pdf](https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf)

<sup>5</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, " Rezolutë për miratimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm". (2018) E qasshme në: [http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/2018\\_01\\_30\\_Rezoluta\\_06\\_R\\_001.pdf](http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/2018_01_30_Rezoluta_06_R_001.pdf)

"Zhvillim të qëndrueshëm", përmes së cilës qytetarët e Kosovës do të informohen rregullisht për progresin e Kosovës në implementimin e OZHQ-ve,

- Në tetor të vitit 2018 është themeluar Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm, i cili do të ketë një rol monitorues për të siguruar që të arrihet mbarëvajtja e zbatimit të OZHQ-ve.
- Në vitin 2021 është lansuar Platforma e OZHQ-ve Drenas, e cila shërben si mjet monitorues dhe raporton mbi 17 OZHQ-të dhe indikatorët përkatës në nivelin komunal.<sup>6</sup>
- Në maj të vitit 2022 Zyra e Kryeministrit publikoi Draftin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit, i cili synon t'i jep kahje zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë për 8 vitet e ardhshme.

## Dokumentet Strategjike të Kosovës për Zhvillim të Qëndrueshëm

### 1. Draft Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2022 – 2030

Në maj të vitit 2022 është publikuar Drafti i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2022 – 2030, me vizion për Kosovë të zhvilluar, me ekonomi të qëndrueshme, mirëqenie, siguri dhe barazi, të integruar në tregjet dhe organizatat ndërkombëtare, me institucione dhe administratë efektive, standarde të ngritura të jetesës, cilësi dhe qasje të mirëfilltë në drejtësi, shëndetësi dhe arsim.

Realizimi i vizionit përmes përmbushjes së objektivave zhvillimore do të mundësojë arritjen e mirëqenies për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Agjenda e Gjelbër trajtohet si një element i rëndësishëm rreth parimeve të një ekonomie me fokus mjedisin e përcaktuar nga rritja e qëndrueshme, konsum të qëndrueshëm të burimeve dhe reduktim të emetimeve të karbonit. Përderisa zhvillimi ekonomik tradicional është i drejtuar nga fitimi, rritja e gjelbër e vendos mirëqenien njerëzore në qendër të zhvillimit ekonomik dhe përpiqet të minimizojë dëmin mjedisor.<sup>7</sup>

### 2. Rezoluta për OZHQ-të

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur në janar të vitit 2018, në përputhje me nenin 65 (1) të Kushtetutës<sup>8</sup> dhe nenin 52 të Rregullores së Kuvendit<sup>9</sup>, ka miratuar Rezolutën për OZHQ-të. Kjo rezolutë shpreh vullnetin e Kosovës për të integruar Agjendën 2030 në strategjitë zhvillimore të Kosovës. Gjithashtu me anë të kësaj rezolute Kuvendi i përkushtohet rolit të tij si njëri ndër organet vendimmarrëse dhe implementuese të Agjendës 2030.

<sup>6</sup> Platforma e OZHQ-ve Drenas. E qasshme në: <https://drenas.tracking-progress.org/>

<sup>7</sup> Draft Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2022 – 2030

<sup>8</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Faqe 22. E qasshme në: [https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se.\\_Kosoves-2.pdf](https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se._Kosoves-2.pdf)

<sup>9</sup> Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faqe 24. E qasshme në: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/Rr\\_K\\_RK\\_29\\_04\\_2010\\_1\\_EDbu8aqXYd.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/6/Rr_K_RK_29_04_2010_1_EDbu8aqXYd.pdf)

<i>Draft - Strategjia Kombëtare e Zhvillimit (2022 - 2030)</i>	<i>OZHQ-të lidhur me SKZH</i>	<i>Numri i indikatorëve që lidhet me fushat e politikave të SKZH</i>
<i>1. Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik</i>	OZHQ 6 (8 indikatorë gjithsej)	3
	OZHQ 7 (5 indikatorë gjithsej)	2
	OZHQ 8 (12 indikatorë gjithsej)	4
	OZHQ 9 (8 indikatorë gjithsej)	1
	OZHQ 11( 10 indikatorë gjithsej)	2
	OZHQ 12 (11 indikatorë gjithsej)	1
	OZHQ 13 ( 5 indikatorë gjithsej)	1
	OZHQ 17 (19 indikatorë gjithsej)	1
<i>2. Zhvillim i barabartë njerëzor</i>	OZHQ 1 (7 indikatorë gjithsej)	3
	OZHQ 4 (10 indikatorë gjithsej)	4
	OZHQ 8 (12 indikatorë gjithsej)	4
<i>3. Siguria dhe sundimi i ligjit</i>	OZHQ 5 (9 indikatorë gjithsej)	0
	OZHQ 16 (12 indikatorë gjithsej)	4
<i>4. Qeverisja e mirë</i>	OZHQ 5 (9 indikatorë gjithsej)	0
	OZHQ 16 (12 indikatorë gjithsej)	1

*Tabela 1: Përafrimi i fushave të politikave të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit me OZHQ-të dhe indikatorët përkatës*

## METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur në këtë raport përbën metodën e hulumtimit në tavolinë dhe analizë e të dhënave statistikore në bazë të të dhënave të marra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Të dhënat janë lidhur me OZHQ-të dhe mundohen të portretizojnë arritjen e përbushjes së tyre gjatë vitit 2021 në Kosovë. Edhe pse analiza bazohet në vitet paraprake, ky raport mendohet të shërbejë si udhërrëfyes për raportet vjetore që do të dalin në vitet e ardhshme.

Miratimi i dokumenteve të ndryshme që mbështesin Agjendën 2030 nuk është progres i mjaftueshëm drejt rrugës së avancimit me kornizat e zhvillimit të qëndrueshëm. Identifikimi i fushave të politikave të cilat kanë nevojë për ndryshim dhe përmirësim paraqesin gjithashtu një hallkë të rëndësishme drejt Agjendës 2030. Ky proces bëhet shumë i vështirë në rastet kur mungojnë të dhënat të cilat i adresojnë këto politika. Agjencia Statistike e Kosovës (ASK), bashkë me institucione të tjera, prodhojnë një sasi të caktuar të të dhënave, por që nuk janë të bollshme për të monitoruar progresin e Kosovës në përbushjen e OZHQ-ve. Të dhënat të cilat janë në dispozicion shërbejnë vetëm për monitorimin e disa indikatorëve bazik, por nuk ofrojnë një pasqyrë më të gjerë të indikatorëve të tjerë. Kjo mungesë e të dhënave është si pasojë e:

1. Mungesës së përgjegjësisë kur vije puna tek ofrimi i të dhënave

ASK apo institucionet e tjera nuk ofrojnë të dhëna lidhur me punën e tyre. Pamjaftueshmëria e të dhënave pamundëson monitorimin e punës së tyre në lidhje me OZHQ-të përkatëse.

2. Të dhëna kontradiktore në mes të institucioneve

Kur institucionet publikojnë të dhëna, shpesh herë ato nuk korrespondojnë me njëra tjetrën. Ky fenomen shpesh herë ndikon që këto të dhëna të mos jenë të besueshme dhe të operueshme.

3. Deficiti i të dhënave që lidhen me OZHQ-të

Të dhënat të cilat janë në dispozicion nga ASK dhe institucionet e tjera, nuk korrespondojnë shumë me indikatorët e OZHQ-ve. Disa indikatorë janë shumë specifik kundrejt të dhënave në Kosovë që janë më të përgjithësuara.

4. Mungesa e trageteve të përcaktuara

Sfidë tjetër e punimit mbetet që Kosova nuk ka targete të përcaktuara për OZHQ-të, andaj edhe vlerësimi numerik se sa janë përbushur ato është i vështirë.

## Përmbushja e OZhQ-ve në Kosovë



### OZHQ 1: PA VARFËRI

*Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj kudo*

#### Vlerësimi i targeteve

1.1 Në Kosovë sipas Bankës Botërore në vitin 2021<sup>10</sup>, 20.9% e popullsisë jeton nën kufirin ndërkombëtar të varfërisë.

1.2 Përqindja e anëtarëve të familjes që jetojnë në ekonomi familjare të privuara nga tre prej nëntë dimensioneve: Nuk mund të përballojnë: 1) të paguajnë qiranë apo faturat komunale, 2) ta mbajnë shtëpinë mjaftueshëm të ngrohtë, 3) të përballojnë shpenzime të papritura, 4) të hanë mish, peshk ose ekuivalent të proteinës çdo të dytën ditë, 5) pushime një-javore larg shtëpisë për të gjithë anëtarët e familjes, 6) makinë, 7) makinë rrobalarëse, 8) TV dhe 9) telefon, në vitin 2019 ka qenë 44.1%.


1.3 Mirëqenia sociale është një target që matet në Kosovë. Në vitin 2021 102.904 banorë kanë përfituar nga ndihmat sociale<sup>11</sup>.

1.5 Në vitin 2020 në Kosovë nuk ka ndodhur ndonjë fatkeqësi natyrore, e cila ka shkaktuar vdekje, zhdukje të personave apo ndikim të drejtpërdrejt tek popullsia. Mirëpo për këtë të dhënë

nuk ka burim zyrtar që tregon një statistikë të tillë.

#### Situata e përgjithshme

Shkalla e varfërisë në vend ka rënë nga 23.7 në vitin 2012 në 18.0 në vitin 2017<sup>12</sup>, mirëpo, Kosova akoma qëndron larg nga vendet e BE pasi që 2 prej 10 banorëve jetojnë me më pak se 5.5\$ në ditë.<sup>13</sup> Gjini koeficient tregon se pabarazia në Kosovë gjatë gjithë periudhës 2012-



2017, u ul vetëm pak. Gjithashtu, pabarazia në këtë periudhë në zonat urbane ka qenë më e lartë se në zonat rurale.

Në Kosovë dy të tretat e popullsisë janë në moshë pune, që është një aset për vendin tonë. Shkalla e papunësisë në

<sup>10</sup> Shqipëri: 2021 Neni IV Konsultimet-Deklaratë për shtyp; Raporti i Stafit; dhe Deklarata e Drejtorit Ekzekutiv për Shqipërinë <https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2021/12/07/Albania-2021-Article-IV-Consultation-Press-Release-Staff-Report-and-Statement-by-the-510834>

<sup>11</sup> Kosova në shifra 2021, ASK

<sup>12</sup> Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës, Banka Botërore dhe ASK, <https://ask.rks.gov.net/media/4882/statistikat-e-varf%C3%ABris%C3%AB-2012-2017.pdf>

<sup>13</sup> World Bank, Kosovo Country Economic Memorandum, Gearing up for a More Productive Future

Kosovë nga 30.9% që ishte në 2012 është ulur në 25.9% në vitin 2020.<sup>14</sup> Mirëpo që nga viti 2012 proporcioni i punësimit të paqëndrueshëm në raport me punësimin në përgjithësi nga 16.8% është ngritur në 23.1% në vitin 2017 dhe pastaj ka rënë përsëri në 17.0% në vitin 2020.<sup>15</sup> <sup>16</sup> Kjo mund të ndikojë që pastaj të rritet edhe përqindja e popullsisë që janë pjesë e skemës sociale.

Burimi më i madh i të ardhurave gjatë periudhës 2014 – 2017 ishin pagat në sektorin privat, me përjashtim të vitit 2015, kur burimi më i madh i të ardhurave ishin pagat në sektorin publik. Shkalla e punësimit për vitin 2020 ishte 28,4 %, ku ka një dallim signifikant mes gjinive. Prej meshkujve në moshë pune 42.8% e tyre ishin të punësuar dhe prej femrave në moshë pune 14.1% ishin të punësuar. Sektorët me përqindjen më

### Ligjet që përfshijnë këtë objektivë



Ligji për skemën e ndihmës sociale në Kosovë



Ligji i Punës



Strategji a Sektorial e 2018-2022



Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti



Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë 2016

të lartë në punësim janë: tregtia 17.0%; prodhimi 11.8%; ndërtimtaria 11.1%; dhe arsimiti 10.1%. Shkalla e punësimit ka pas ulje dhe ngritje përgjatë 8 viteve të fundit. Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore, ngritje signifikante ka pasur në vitin 2017 dhe 2019. Ndërsa, ulje kishte përgjatë viteve të tjera, një e tillë u pa edhe në vitin 2020, e cila mund të ketë ndodhur si shkak i pandemisë. Shkalla e punësimit në raport të popullsisë është paraqitur më poshtë për periudhën 2012 deri 2020.

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Përqindja	25,2	28,0	29,8	28,8	30,1	28,4

Tabela 1. Raporti i punësimit për vitet 2012 - 2020<sup>17</sup>

<sup>14</sup> Papunësia dhe shkalla e papunësisë sipas gjinisë, ASK. E qasshme këtu: [https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata\\_\\_\\_Labour%20market\\_\\_\\_Anketa%20e%20Fuqis%c3%ab%20Pun%c3%ab%20Abetore\\_\\_\\_Annual%20labour%20market/tab18.px/table/tableViewLayout1/](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata___Labour%20market___Anketa%20e%20Fuqis%c3%ab%20Pun%c3%ab%20Abetore___Annual%20labour%20market/tab18.px/table/tableViewLayout1/)

<sup>15</sup> Punësimi i paqëndrueshëm sipas gjinisë, ASK. E qasshme këtu: [https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata\\_\\_\\_Labour%20market\\_\\_\\_Anketa%20e%20Fuqis%c3%ab%20Pun%c3%ab%20Abetore\\_\\_\\_Annual%20labour%20market/tab6.px/table/tableViewLayout1/](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata___Labour%20market___Anketa%20e%20Fuqis%c3%ab%20Pun%c3%ab%20Abetore___Annual%20labour%20market/tab6.px/table/tableViewLayout1/)

<sup>16</sup> Punëtorët në punë të paqëndrueshme janë ose persona të vetëpunësuar pa punonjës, ose ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar

<sup>17</sup> ASK. 'Të punësuarit dhe raporti ndaj popullsisë'. I qasshëm në: [https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata\\_\\_\\_Labour%20market\\_\\_\\_Anketa%20e%20Fuqis%c3%ab%20Pun%c3%ab%20Abetore\\_\\_\\_Annual%20labour%20market/tab2.px/table/tableViewLayout1/](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata___Labour%20market___Anketa%20e%20Fuqis%c3%ab%20Pun%c3%ab%20Abetore___Annual%20labour%20market/tab2.px/table/tableViewLayout1/)



## Sfidat kryesore

- Siç u cek edhe më lartë, Kosova ka një përqindje të ulët të popullsisë së punësuar. Sipas tabelës së paraqitur më lartë, shihet se viti 2020 ka pasur shkallë të punësimit për 1.7% më të ulët se në viti 2019. Shkalla e punësimit ishte më e lartë për meshkuj (42.8%) se sa për femra (14.1%).<sup>18</sup>
- Shifrat e papunësisë në Kosovë nuk e pasqyrojnë 100% gjendjen reale, për shkak të ekonomisë joformale apo punësimit ilegal. Kjo është një çështje tjetër e cila duhet të adresohet në vitet në vazhdim.
- Shkalla e punësimit nëpër grup mosha ishte më e larta në mesin e personave të moshës mes 35-44 vjeç me 38.2% dhe më e ulët në mesin e të rinjve mes 15-24 vjeç me 11.4 %.<sup>19</sup> Kjo tregon që ka një shkallë të lartë të papunësisë tek të rinjtë, që pastaj rezulton edhe në migrimin e kësaj grup moshe.
- Një problem me të cilin po ballafaqohet rinia në Kosovë sot është që aftësitë që kërkohen në tregun e punës nuk po reflektohen në aftësitë që mësohen në shkolla apo universitete. Kjo kërkon reforma të thelluara në fushën e arsimit.

## Hapat e ardhshëm

- Të bëhen reforma në fushën e arsimit në mënyrë që të ngritën kapacitetet e fuqisë punëtore. Në mënyrë që të përmbushen kërkesat e punëdhënësve, sistemi jonë arsimor duhet të orientohet kah aftësitë që kërkohen në treg.
- Të miratohet ligji për paga që të rregulloj sistemin e pagave. Miratimi i këtij ligji poashtu sjell një barazi mes punëtorëve të sektorit privat dhe punëtorëve të sektorit publik.
- Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara për t'iu siguruar punë për të arritur gjithëpërfshirje.
- Hartimi i një Strategjie Kombëtare të Punësimit, në mënyrë që të adresohen të gjitha problematikat e fushës së punësimit dhe të përcaktohet rruga drejt të cilës Kosova do të luftojë papunësinë.
- Institucionet lokale mund të rrisin bashkëpunimin me bizneset për të krijuar mundësinë e krijimit dhe përfshirjes së këtyre kategorive në punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
- Të zgjerohet mbulueshmëria e skemave sociale në vend deri sa të arrijë në 100%.

---

<sup>18</sup> 'Të punësuarit dhe raporti ndaj popullsisë' ASK. I qasshëm në: [https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata\\_\\_Labour%20market\\_\\_Anketa%20e%20Fuqis%3ab%20Pun%3abtoe\\_\\_Annual%20labour%20market/tab2.px/table/tableViewLayout1/](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Labour%20market__Anketa%20e%20Fuqis%3ab%20Pun%3abtoe__Annual%20labour%20market/tab2.px/table/tableViewLayout1/)

<sup>19</sup> Ibid.



## OZHQ 2: ZERO URI

*Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i ushqyerjes dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme*

### Vlerësimi i targeteve

2.A Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi në Bruto Produktin Vendor (BPV) në total përfshijnë 6.9%.<sup>20</sup> Në vitin 2020 subvencionet arritën vlerën 67.05 mil. €, prej të cilave rreth 62% kanë qenë për kultura bujqësore duke përfshirë verën, fidanet si dhe primin e sigurimit ndërsa 38% kanë qenë për sektorin e blegtorisë.<sup>21</sup>

2.B Sipas Raportit të Gjellbër pjesëmarrja e bujqësisë në eksportin e përgjithshëm gjatë vitit 2020 ka arritur vlerën më të lartë 39.5%.

### Situata e përgjithshme

Historikisht Kosovën e ka karakterizuar uria si pasojë e varfërisë. "Në vitin 1999 në Kosovë, 11,000 fëmijë në moshë mbi 5 vjeç vlerësohej të ishin të kequshqyer në mënyrë akute dhe rreth 17,000 do të prekeshin nga ngecja në rritje. Mbi 5% e nënave të anketuara kishin një BMI nën 18.5 dhe më shumë se 10% ishin obeze. I njëjti raport thoshte se "58% e fëmijëve ishin anemikë". Këto statistika janë pengesa të rëndësishme për zhvillimin e vendit.<sup>22</sup>

Në korrik të vitit 2022 MASHT ka

publikuar Udhëzuesin për Planifikimin e Ushqyerjes në Institucionet Parashkollore, që ofron informatat kyçe mbi rëndësinë dhe parimet e ushqyerjes së drejtë në fëmijërinë e hershme, promovon ushqyerjen e shëndetshme tek fëmijët dhe shprehitë e shëndetshme, dhe ofron shembuj të menuve të ushqimit sipas grupmoshave dhe stinëve.<sup>23</sup>

Pasiguria ushqimore është shumë e përhapur. Përveç mungesës së qasjes së vazhdueshme në ushqim, është edhe më e vështirë për njerëzit që të gjejnë ushqime me vlera ushqyese adekuate. Normat e obezitetit dhe anemisë janë rritur për shkak të mungesës së qasjes të vazhdueshme në ushqime me vlera ushqyese. Banka Botërore thekson se "prodhuesit e ushqimit përballen gjithashtu me humbje të mëdha në ushqimin me vlera ushqyese që prishet pasi konsumi zhvendosen drejt produkteve më të lira". Humbja e ushqimeve me vlera ushqyese kontribuon më tej në problemin e sigurisë së të ushqyerit dhe shkakton çrregullime shëndetësore si në obezitet dhe anemi.

Sipas Anketës së Ekonomive Bujqësore 2021, gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e

<sup>20</sup> Struktura e Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2021, ASK.

<sup>21</sup> Raporti i Gjellbër 2021, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

<sup>22</sup> The Process of Reducing Hunger in Kosovo, Allyson Reeder. E qasshme këtu: <https://borgenproject.org/the-process-of-reducing-hunger-in-kosovo/>

<sup>23</sup> Planifikimi i Ushqyerjes në Institucionet Parashkollore, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. E qasshme këtu: [https://masht.rks-gov.net/planifikimi-i-ushqyerjes-ne-institucionet-parashkollore/?fs=e&s=cl&fbclid=IwAR2iTUXPXMtNvPdT6kOb9tPJCUsN3ZGiTuwpYZ-\\_YS4gvFgPOztIRCHZYM0](https://masht.rks-gov.net/planifikimi-i-ushqyerjes-ne-institucionet-parashkollore/?fs=e&s=cl&fbclid=IwAR2iTUXPXMtNvPdT6kOb9tPJCUsN3ZGiTuwpYZ-_YS4gvFgPOztIRCHZYM0)

tokës bujqësore ishte 420,326.60 hektarë<sup>24</sup>, ku pjesën më të madhe e kanë livadhet dhe kullosat (përfshirë tokën e përbashkët) me 217 106,91 ha ose (51,65 %).

Kultura që mbillet më së shumti në toka të punueshme-ara është drithëra kokërr, që përbëjnë 66.1% të tokës.



Në Kosovë, bujqësia dhe industria e ushqimit mbeten kontribues të rëndësishëm në Bruto Produktin Vendor

(BPV). Në fund të vitit 2021, bujqësia, pylltaria dhe peshkimi u vlerësua se kontribuan me 550,948,000 EUR në BPV<sup>25</sup>. Ky aktivitet, ishte kontribuesi i katërt më i madh në BPV.

Sipas vjetarit statistikor të vitit 2022 të publikuar nga ASK-ja, norma e punësimit në bujqësi, pylltari dhe peshkatari ishte 4.8% në vitin 2020, që është 0.4% më e vogël se në vitin paraprak. Megjithatë eksportet kanë pësuar trend pozitiv të rritjes nga 2011-2021, me rritje të produkteve bimore nga 12,7 milionë Euro në 31,9 milionë Euro, ushqime të përgatitura, pije, pije alkoolike dhe duhan nga 12,9 milionë Euro në 57,7 milionë Euro.<sup>26</sup>

Kosova ka bërë progres në zhvillimin e infrastrukturës së saj të TI-së për kontrollin e sigurisë ushqimore dhe sistemin e menaxhimit të informacionit laboratorik.<sup>27</sup> Përpjekje të mëtejshme duhet të bëhen për të arritur harmonizimin e legjislacionit me acquis të BE-së për të siguruar zbatimin e legjislacionit për sigurinë ushqimore dhe fitosanitar.

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë



Ligji i produktëve për mbrojtje në bimëve



Ligji për ushqimin



Ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve



Ligji për veterinarinë



Ligji për inspektionin bujqësor



Ligji për bujqësinë organike



Ligji për blegtorinë e Kosovës



Ligji për peshkatari dhe akuakulturë

<sup>24</sup> Anketa e Ekonomive Bujqësore 2021, ASK. E qasshme këtu: <https://ask.rks-gov.net/media/6907/anketa-e-ekonomive-bujq%C3%ABsore-2021.pdf>

<sup>25</sup> Bruto Produkti Vendor 2008 – 2021, ASK. E qasshme këtu: <https://ask.rks-gov.net/media/7027/bpv-2008-2021finali.pdf>

<sup>26</sup> Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), 2021

<sup>27</sup> KE, Raporti për Kosovën 2021

## Sfidat kryesore

- Mungesa e kapaciteteve administrative për vlerësim, monitorim dhe kontabilitet brenda Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë ende mbetet një sfidë e cila duhet të tejkalohet.
- Toka e punueshme bujqësore është e fragmentuar dhe kryesisht ka ferma të vogla, gjë e cila paraqet vështirësi për identifikimin e parcelave të tokës.
- Programet e ndryshme të Qeverisë për bujqësi dhe zhvillim rural e kanë rritur mbështetjen për fermerët e vogël, por monitorimi i granteve dhe i rezultatit të tyre ka mbetur ende mbrapa.
- Shumë shqetësuese në Kosovë është edhe degradimi i tokave bujqësore, të cilat po humbin kryesisht nga ndërtimi. Kosova humb çdo vit nga 500 deri në rreth 1 mijë hektarë tokë, qoftë nga ndërtimet banesore apo edhe nga ndërtimi i rrugëve të ndryshme.

## Hapat e ardhshëm

- Krijimi i një agjencie vendore të bujqësisë organike.
- Krijimi i një strategjie dhe plani të veprimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ruajtjen e tokave bujqësore nga degradimi.
- Krijimi i strategjisë së menaxhimit të qëndrueshëm të sistemit të tokës.
- Implementimi i një sistemi të integruar të kontrollit të ushqimit.



## OZHQ 3: SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE

*Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat*

### Vlerësimi i targeteve

3.2 Kosova qëndron shumë mirë në raport me targetin për shkallën ndërkombëtare të vdekshmërisë. Në Kosovë gjatë vitit 2020 ka pasur gjithsej 85 vdekje të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare ose 3.7 vdekje për 1000 lindje dhe 55 vdekje neonatale, përkatësisht 2.5 vdekje për 1000 lindje.

3.3 Në Kosovë numri i rasteve me tuberkuloz ka rënë nga 1776 sa ishte në vitin 2000, në 441 në vitin 2020. Kurse për numrin e të infektuarve me Hepatit B ka të dhëna vetëm për një vdekje të regjistruar.

3.4 Numri i rasteve të vdekjes nga vetëvrasjeve gjatë vitit 2019 ka arritur vlerën 39.

3.6 Numri i vdekjeve të shkaktuara nga lëndimet e trafikut rrugor në Kosovë gjatë vitit 2020 ka pësuar rënie krahasim me vitin paraprak. Në vitin 2019 janë regjistruar 60 fatalitete për një milion banorë, kurse në vitin 2020 ky numër ka rënë në 43 fatalitete për një milion banorë.

3.7 Lindjet në moshë të adoleshencës, nga 10 – 19 vjeç për vitin 2020 janë në shkallë relativisht të vogël në Kosovë, 0.24, kurse për vitin 2021 kjo shkallë u

ngrit në 0.25.

3.9 Shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet ndotjes së ajrit në Kosovë gjatë vitit 2021 ishte 12.1%.<sup>28</sup>

3.A Përdorimi i duhanit mbi moshën 16 vjeçare në Kosovë për herë të fundit është matur në vitin 2017, dhe ka rezultuar se 16% e popullatës janë duhanpirës.<sup>29</sup>

### Situata e përgjithshme

Nevojat e qytetarëve për një sistem efektiv dhe gjithëpërfshirës shëndetësor vazhdimisht po rritet. Kjo shton nevojën për politika më të mira shëndetësore dhe shtim të kapaciteteve në institucionet shëndetësore. Në kuadër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) janë gjithsej 36 klinika dhe 3 441 të punësuar. Megjithatë, gjatë krizës së pandemisë COVID-19, dy nga ankesat më të shpeshta të qytetarëve ndaj shërbimeve mjekësore ishte mungesa e stafit mjekësor në vendin e punës dhe mos funksionimi i disa QMF, AMF dhe disa shërbimeve shëndetësore në klinika.


Jetëgjatësia mesatare në Kosovë për vitin 2011, viti kur është bërë regjistrimi i popullsisë për herë të fundit, është vlerësuar të jetë 76.7 vite, për meshkuj 74.1 vite, kurse për femra 79.4 vite.<sup>30</sup>

<sup>28</sup> Raporti Vjetor i Ajrit 2021, AMMK

<sup>29</sup> ASK, Anketa e Buxhetit të Familjes, Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2017

<sup>30</sup> Vjetari statistikor i Republikës së Kosovës 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës

Një përmirësim i dukshëm është vërejtur në uljen e shkallës së vdekshmërisë nën moshën 5 vjeçare, ku numri i vdekjeve është ulur nga 274 në vitin 2019 në 212, megjithatë vdekshmëria neonatale ka shënuar rritje për 40.3 %. Në vitin 2019 janë regjistruar 2 raste të vdekjeve nga shtatëzania, lindja ose lehonja. Si pasojë e sëmundjeve psikike dhe të sjelljes në të njëjtin vit kanë ndodhur 12 raste të



vdekjes.<sup>31</sup> Sa i përket numrit të viktimave të vetëvrasjeve, ka pasur një trend të rritjes nga 27 në vitin 2018 në 39 në vitin 2019.<sup>32</sup> Një ulje të kënaqshme ka pasur edhe shkalla e vdekjes për shkak të lëndimeve në trafikun rrugor, e cila ka rënë nga 113 në vitin 2019, në 81 në vitin 2020.<sup>33</sup> Numri i të vdekurve nga sëmundjet ngjitëse gjatë vitit 2020, është 1344, ku dominojnë vdekjet nga COVID-19.

Sipas Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë si rrjedhojë e popullatës së re në Kosovë, gjendja e përgjithshme shëndetësore e popullatës cilësohet e mirë, me faktorë të ultë të rizikut sa i


<sup>31</sup> Statistikat e vdekjeve, ASK. E qasshme këtu: <https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/>

<sup>32</sup> Po aty.


<sup>33</sup> Po aty.

përket përdorimit të alkoolit, konsumimit të kënaqshëm të frutave dhe aktivitetit fizik. Gjithashtu përqindja e popullsisë e mbuluar nga të gjitha vaksinat e përfshira në programin kombëtar përgjatë viteve 2011-2016 ka qenë gjithmonë mbi 94%.

Në klinikën e Kardiologjisë dhe Kardiologjisë Invazive janë kryer 2,524 koronografi, ndërsa janë vendosur 1,450 stenta dhe janë kryer 252 operacione në këtë klinikë.



Në klinikën e Onkologjisë si raste të reja janë paraqitur 1626 pacientë. Ndër ta janë 398 raste me sëmundje malinje të gjirit, 213 raste me sëmundje të mushkrive, 391 raste me sëmundje të traktit gastrointestinal, 419 raste me sëmundje urogjenitale dhe gjinekologjike dhe 205 sëmundje tjera të kokës, qafës, inde të buta, SNQ dhe sëmundje tjera.<sup>34</sup>



Cilësia e ajrit në Kosovë gjatë vitit 2021 ka shënuar një mesatare prej 56 të

<sup>34</sup> Raporti i punës për ShSKUK, 2021. E qasshme këtu: <https://shskukadmin.rks-gov.net/Medias/PDF-%20Raporti%20i%20pun%C3%ABs%20nga%20ShSKUK.%20p%C3%ABr%20vitin%202021.pdf>

indeksit të cilësisë së ajrit. Grimcat PM2.5 gjatë këtij viti kanë qenë 2.9 herë më të koncentruara se sa vlera e rekomanduar e OBSH.<sup>35</sup> Në Kosovë nuk

ka të dhëna mbi rastet e vdekjeve si pasojë e ndotjes së ajrit, mirëpo mesatarja rajonale është 35.95 për 100,000 banorë.<sup>36</sup>

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë



Ligji për  
Inspektorati  
n Sanitar të  
Kosovës



Ligji për  
Shëndetësi



Ligji për  
sigurime  
shëndetsore



Ligji për  
Kryqin e  
Kuç të  
Kosovës



Ligji për  
shëndetsinë  
publike



Ligji për  
shëndetin  
mendor

## Sfidat kryesore

- Njëra ndër sfidat kryesore me të cilat përballet sistemi shëndetsor publik i Kosovës është mungesa e pajisjeve në qendrat klinike si dhe mungesa e stafit mjeksor në zonat rurale. Përmirësimi i infrastrukturës së objekteve të klinikave si dhe sigurimi i pajisjeve të reja mjeksore duhet në jetë në listën e prioriteteve të institucioneve relevante për fushën e shëndetsisë.
- Një tjetër sfidë me të cilën po përballet sektori shëndetsor është rritja e vdekshmërisë neonatale, e cila vije si pasojë e faktorëve të ndryshëm.
- Problemet e shëndetit që lidhen me faktorë mjedisor gjithashtu janë të shumta. Ndotja e lartë e ajrit, si njëra ndër sfidat më të mëdha të ndotjes, është shkaktarë i shumë sëmundjeve, sidomos të atyre të sistemit të frymëmarrjes.

## Hapat e ardhshëm

- Institucionet e kujdesit shëndetsor duhet të duhet të marrin parasysh nevojën për të përmirësuar aspektet teknike të spitaleve si dhe procesin e kujdesit.
- Modernizimi i mëtutjeshëm i sistemit shëndetsor përmes platformës e-Kosova.
- Draftimi i një strategjie të re sektoriale shëndetsore, e cila do të përgaditet në frymën e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- Në kuadër të modernizimit të sistemit shëndetsor të bëhet edhe trajnimi i stafit shëndetsor publik për përgaditjen e tyre profesionale rreth metodave të reja të komunikimit mjek – pacient dhe përdorimit të pajisjeve shëndetsore të

<sup>35</sup> Air Quality in Kosovo, IQAir. E qasshme këtu:  
<https://www.iqair.com/kosovo>

<sup>36</sup> International Data and Economic Analyses, USAID.  
E qasshme këtu:

<https://idea.usaid.gov/cd/kosovo/environment-and-global-climate-change>

- teknologjisë së fundit.
- Duhet të rritet numri i personelit shëndetsor njëkohësisht dhe furnizimi me pajisje në zonat rurale.





## OZHQ 4: ARSIM CILËSOR

*Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë*

### Vlerësimi i targeteve

4.2 Për shkak të mungesës së të dhënave të sakta mbi statistikat e popullsisë është e vështirë të përcaktohet shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve në shkollim. Numri i fëmijëve të regjistruar në çerdhe dhe parashkollor gjatë vitit 2021/2022 ishte 32,397.<sup>37</sup>

4.3 Në pjesëmarrjen e të rinjëve dhe të rriturve në arsim dhe trajnim ka një zbrazëti mes meshkujve dhe femrave, me pjesëmarrje më të lartë tek meshkujt. Ndërsa në regjistrimin e arsimit të lartë femrat dominojnë kundrejt meshkujve.<sup>38</sup>


4.5 Indeksi i barazisë gjinore gjatë vitit 2021 ka pasur rritje në nivelin parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.

4.C Burimet njerëzore në aspektin e numrit të mësimeve në raport me numrin e nxënësve janë zvogëluar nga viti akademik 2019/2020.<sup>39</sup>

### Situata e përgjithshme

Në Kosovë të gjithë fëmijët e kanë mundësinë e arsimit primar dhe sekondar falas, sepse këto dy nivele janë të detyrueshme, kurse niveli parashkollor dhe universitar nuk janë të detyrueshëm, prandaj nuk janë falas.

Numri i fëmijëve në arsim parashkollor dhe parashkollorë gjatë periudhës 2020/2021 ka pasur një ulje krahasuar me vitin paraprak, kurse gjatë 2021/2022 ky numër është ngritur. Ulje e numrit të nxënësve është vërejtur



edhe në nivelet e tjera të shkollimit, kurse në arsimin universitar në vitin akademik 2020/21 nuk ka pasur rritje të numrit të studentëve, mirëpo në vitin akademik 2020/2021 kanë raportuar të gjitha kolegjet private, gjë që kjo ka ndikuar që numri i studentëve të jetë më i madh, krahasuar me vitin paraprak 2019/2020, ku për shkak të situatës me

<sup>37</sup> Statistikat e Arsimit, ASK.

<sup>38</sup> Po aty.

<sup>39</sup> MASHT, Raport vjetor statistikor me tregues arsimorë 2020/21

COVID 19, ka pasur raportim vetëm nga 9 Kolegje Private. Pra mund të themi se ka pasur një gjithëpërfshirje të numrit të studentëve nga të gjitha Universitetet Publike dhe Kolegjeve Private dhe jo rritje të numrit të studentëve.

Sipas testit PISA të Organizatës për Bashkëpunimin dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Kosova nuk shënon përmirësime sa i përket rezultateve. Në vitin 2015 Kosova ishte radhitur në 5 vendet e fundit në tabelën e rezultateve të PISA-s. Vlerësimi është bërë në fushat e leximit, matematikës dhe shkencës. Në vitin 2018, pikët ishin më të ulëta krahasim me vitin 2015 në shkencë. Në fushat e tjera ishin rritur. Këto rezultatet jo të kënaqshme kanë marrë vëmendjen e institucioneve përkatëse të fushës së arsimit. Plani Strategjik i Arsimit 2017 – 2021, në objektivin 3 (Sigurimi i cilësisë) e adreson këtë çështje. Kjo objektive e sheh testin PISA si mjet të përmirësimit të cilësisë sepse " *ofron informacion sistematik për anomalitë e sistemit dhe kurrikulumit*".


Një dukuri pozitive që është vërejtur në Kosovë është knaqësia e nxënësve me jetën. Sipas raportit të OECD për PISA 2018, 82% e studentëve (mesatarja e OECD: 67%) raportuan se janë të kënaqur me jetën e tyre.

Shkalla e punësimit tek të rinjtë ka rënë

nga viti 2019 në vitin 2020, kjo rënie mund ti atribuohet pandemisë COVID-19.

Në aspektin e barazisë gjinore sipas statistikave Kosova qëndron mjaft mirë. Personeli i arsimit publik është i ndarë në 49% meshkuj dhe 51% femra<sup>40</sup>. Nxënësit në nivele të ndryshme arsimore mesatarisht janë me pjesëmarrje 51.6% meshkuj dhe 48.4% femra.<sup>41</sup>

Në objektivat e Pakos së Ringjalljes



Ekonomike është përfshirë edhe fusha e arsimit. Masa 1.5 e kësaj pakoje "Trajnimi dhe punësimi në TI" janë ndarë një milion euro (1,000,000 €) për subvencionimin e bursave për vajzat në fushën e STEM-it (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, dhe Matematikë) dhe një milion euro (1,000,000 €) për trajnimin e të rinjve maturantë në fushën e TI-së. 4.<sup>42</sup> Me këtë masë është synuar mbështetja e edukimit për talentet e reja në fushën e TI në mënyrë që të ketë kuadro për një të ardhme dixhitale të vendit.

<sup>40</sup> Personeli në arsim publik, ASK. E qasshme këtu: [https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata\\_Education\\_09%20Annex/ars2.px/table/tableViewLayout1/09%20Annex/edu38.px/table/tableViewLayout1/](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata_Education_09%20Annex/ars2.px/table/tableViewLayout1/09%20Annex/edu38.px/table/tableViewLayout1/)

<sup>41</sup> Numri i nxënësve sipas gjinisë, ASK. E qasshme këtu: [https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata\\_Education\\_09%20Annex/ars2.px/table/tableViewLayout1/09%20Annex/edu38.px/table/tableViewLayout1/](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata_Education_09%20Annex/ars2.px/table/tableViewLayout1/09%20Annex/edu38.px/table/tableViewLayout1/)

<https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1.2.1130>

<sup>42</sup> Lajme nga Ministria e Financave. E qasshme këtu: <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1.2.1130>

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë



Ligj për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë



Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore



Ligji për veprimtaritë kërkimore-shkencore



Ligji për kualifikimet



Ligji për Arsimin e Lartë



Ligji për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur

## Sfidat kryesore

- Sfida e parë me të cilën përballlet sistemi arsimor në Kosovë është gjithëpërfshirja. Fatkeqësisht kemi nivel të ulët të përfshirjes së fëmijëve nga grupet e marginalizuara dhe nga grupet e fëmijëve me nevoja të veçanta. Kjo së pari vije si pasojë që politikë-bërja nuk bazohet në të dhëna statistikore nga fusha e arsimit. Është e nevojshme të dihet saktë numri i fëmijëve nga të dy grupet e cekura më parë në mënyrë që të krijohen politika që përfshijnë edhe nevojat e tyre.
- Sfida e dytë është cilësia e arsimit. Ky problem ka marrë vëmendje akoma më të madhe pas rezultateve të testit PISA. Performanca e ulët e Kosovës në këtë test ka shfaqur nevojën thelbësore për reforma në sistemin arsimor. Këto reforma kërkojnë që të bëhet ri-vlerësim i mësimdhënësve, materialeve studimore, metodave të mësimdhënies, etj.
- Një gjë tjetër e cila e pengon rritjen e cilësisë së arsimit është qasja në tekste mësimore adekuate, kompjuterë dhe laboratorë në shkolla. Edhe pse disa shkolla janë të pajisura me laboratorë dhe kompjuterë, numri i tyre është i vogël.
- Gjithashtu qasja në pajisje teknologjike dhe integrimi i tyre në procese mësimore nuk është i mjaftueshëm sepse një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve kanë vështirësi në përdorimin e teknologjisë gjatë orëve të tyre mësimore. Ndonëse nuk kemi të dhëna konkrete se sa është ky numër, prapë se prapë është shqetësuese që kriteri për njohuri në pajisje të përditshme teknologjike nuk zbatohet goftë në rastet e punësimit të mësimdhënësve të ri apo edhe në rievaluimin e mësimdhënësve të pranishëm.

## Hapat e ardhshëm

- Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve arsimore në mënyrë që të inkurajohet përfshirja e nxënësve dhe studentëve me nevoja të veçanta dhe të zvogëlohen paparazitë aq sa është e mundshme.
- Rritja e numrit të mësimdhënësve/asistentëve për arsim të fëmijëve me nevoja

të veçanta.

- Ngritja e kapaciteteve të inspektorëve, drejtorëve dhe koordinatorëve për sigurim të cilësisë, në mënyrë që të monitorohet performanca e mësimeve dhe nevojat e tyre për zhvillim profesional.
- Ngritja e kapaciteteve të mësimeve është kyçe për të rritur cilësinë e arsimit në Kosovë. Me zhvillimin e teknologjisë edhe organizimi i mësimit duhet të ndryshojë dhe kjo kërkon një staf të trajnuar.
- Sistemi i pagave i bazuar në sistemin e karrierës të mësimeve duhet të ndryshohet në sistem të pagave bazuar në performancë të mësimeve.
- Rritja e koordinimit mes MASHT, Këshilli për Arsimin e dhe Aftësim Profesional dhe të Rriturve, Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimeve dhe shkollave të AAP-së.



## OZHQ 5: BARAZI GJINORE

### *Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave*

#### Vlerësimi i targeteve

5.2 Numri i rasteve të dhunës fizike dhe seksuale në vitin 2021 në Kosovë ka pësuar rritje, duke arritur numrin e grave viktime të cilat kanë raportuar dhunë në familje në 2432 ose ngritje prej 17.54%.<sup>43</sup>

5.3 Martesat e personave të mitur është një dukuri e pranishme në Kosovë, dhe në vitin 2021 sipas ASK janë regjistruar 975 martesat të rinjëve nga mosha 16 – 19 vjeç.

5.5 Që nga pas lufta në Kosovë numri i grave në pozita qeveritare ka filluar të ngritet, mirëpo në raport me numrin e burrave proporcioni ka shumë hapësirë për tu përmirësuar. Aktualisht kemi 6 gra në pozita të ndryshme qeveritare.

5.6 Të drejtat për qasje universale në shëndetin riprodhues dhe të drejtat për informim në shëndetin seksual garantohen me Ligjin për Shëndetin Riprodhues.

#### Situata e përgjithshme

Çështja e barazisë gjinore në Kosovë trajtohet në nivele të ndryshme, duke filluar nga Kushtetuta dhe ligjet përkatëse. Ligji për barazi gjinore, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive. Një hap më tej Kosova e ka bërë me miratimin e pakos së legjislacionit për të drejtat e njeriut, i

cili hyri në fuqi në korrik 2015. Gjithashtu Kuvendi i Kosovës e ka edhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione i cili i shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me përcjelljen dhe me zbatimin e parimit të barazisë gjinore më legjislacion. Një organ tjetër i cili merret ekskluzivisht me çështjen e barazisë gjinore është Agjencia për Barazi gjinore në kuadër të zyrës së Kryeministrit, e cila është përgjegjëse për *“promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, në Kosovë”*.


Në maj të vitit 2020 u miratua Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020-2024. Objektivi i përgjithshëm strategjik i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore është që barazia gjinore të jetë fokus i politikave, procedurave dhe programeve të Qeverisë, agjencive dhe shoqërisë civile. Më 26 janar të vitit 2022 u miratua në Qeveri, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026, si dhe Plani i saj i Veprimit. Kjo çështje trajtohet gjithashtu në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Kodit Penal dhe Ligjit për Barazinë Gjinore.

Pavarësisht ekzistimit dhe përmirësimit të praktikave ligjore që e promovojnë

<sup>43</sup> Raporti vjetor i punës i policisë së Kosovës 2021

barazinë, situata aktuale është ndryshe. Modelet gjinore patriarkale janë akoma mbizotëruese, ndonëse kanë filluar të zbehen pas vitit 2008. Ka një trend në rritje të femrave që përzgjidhen si anëtare të parlamentit pa kuota gjinore. Por, gratë pavarësisht përmirësimeve mbeten të nënpërfaqësuar në pozita udhëheqëse. Pozitën e kryeministres nuk e ka mbajtur asnjëherë një grua dhe që nga viti 2008 gratë kanë qenë të nënpërfaqësuar si ministra dhe zëvendës ministra (vetëm 20%). Poashtu, gratë janë lënë anash në aspektin e dialogut me Serbinë, si eksperte dhe në konsultime publike. Vetëm 26% e zyrtarëve në misione jashtë shtetit janë gra.<sup>44</sup>

Gratë mbeten të nënpërfaqësuar në kuvendet komunale (35%) dhe parlament (32%); si nëpunës civilë në pozita të larta vendimmarrëse në nivel komunal (20%) dhe në nivel kombëtar (27%), si dhe në dialog dhe negociata me shtetet e tjera. Nëse e shikojmë raportin gjinor mes studentëve në universitete publike dhe private, vërejmë numri i studenteve femra është më i lartë, por e kundërta ndodh në zonat rurale, ku numri i femrave që e braktisin shkollën



<sup>44</sup> Kosovo Brief Gender Profile, Rrjeti i Grave të Kosovës.

<sup>45</sup> Anketa e Fuqisë Punëtore 2020, ASK

<sup>46</sup> Analiza Gjinore e Kosovës 2018, Rrjeti i Grave të Kosovës

është më i lartë se meshkujt.


Një raport pabarazie vërehet edhe fuqinë punëtore. Norma e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore gjatë vitit 2020 ishte total 38.3%, ku prej tyre 56% ishin meshkuj dhe 20.8% ishin femra. Gjithashtu edhe norma e punësimit është më e ulët tek femrat. Gjatë vitit 2020 norma e përgjithshme e punësimit ishte 28.4%, ku meshkuj ishin 42.8% dhe femra 14.1%. Shkalla e papunësisë për femra ishte 32.3%, ndërsa për meshkuj 23.5%. Fushat e ekonomisë në të cilat dominon gjinia femrore janë: aktivitete financiare dhe të sigurimit, aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike, aktivitete administrative dhe mbështetëse, arsim, shëndetsi njerëzorë dhe aktivitete të punës sociale. Nga kjo kuptojmë se femrat janë kryesisht të punësuar në aktivitetet e ekonomisë terciare (shërbimeve).<sup>45</sup> Pavarësisht përmirësimeve, gratë ende zotërojnë dukshëm më pak prona (17% të pronave) sesa burrat, gjë e cila kombinuar bashkë me faktorë të tjerë social e minimizon pjesëmarrjen e grave në fuqi punëtore formale.<sup>46</sup> Ndërsa në pronësi të ndërmarrjeve femrat paraqesin 21.9% të pronareve, përkundër meshkujve që janë pronarë të 73.15% të ndërmarrjeve.<sup>47</sup>

Shqetësuese është edhe numri i rasteve të viktimave të dhunës në familje, ku shumica e viktimave janë gra. Gjatë vitit 2019 sipas të dhënave nga Policia e Kosovës, nga gjithsej 1978 viktima që kanë raportuar dhunë në familje, prej tyre 1593 ishin femra dhe 385 ishin meshkuj.<sup>48</sup>

<sup>47</sup> Repertori statistikor i ndërmarrjeve, ASK

<sup>48</sup> Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 - 2026

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë



Ligji për barazi gjinore



Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi



Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 - 2026



Kodi Penal



Ligji për shëndetin riprodhues

## Sfidat kryesore

- Një faktor kyç që kontribuon në pjesëmarrjen e ulët të fuqisë punëtore të grave janë përgjegjësitë e kujdesit, kryesisht kujdesi për fëmijët. Përgjegjësia për kujdesin ndaj fëmijëve zakonisht bie mbi nënat, duke ia u vështirësuar atyre çasjen në tregun e punës.
- Kufijtë sociokulturorë dhe aksesit i kufizuar në financa gjithashtu paraqet pengesë në zhvillimin e femrave. Tradicionalisht gratë në Kosovë rrallë herë kanë gëzuar prona të trashëguara nga prindërit, dhe kjo ka krijuar një disavantazh të dukshëm në gjendjen ekonomike të tyre.
- Një dukuri që i shkel në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat e njeriut në përgjithsi, dhe të drejtat e grave në veçanti është dhuna në familje. Reagimi institucional në këto raste mbetet i dobët, gjë që i dekurajon qytetarët të raportojnë rastet e dhunës në familje. Problemet te reagimi i institucioneve qëndrojnë në çështjet si: përgjigje e vonuar ndaj akuzave, burgosja e rrallë e kryerësve të krimit dhe dënimeve të lehta.
- Një tjetër shqetësim që ka baza gjinore është edhe çështja e shëndetit dhe qasjes në shërbime shëndetsore. Në mungesë të kujdesit adekuat, shërbimeve këshillimore dhe edukative, si dhe si rezultat i normave patriarkale brenda familjeve, vajzat adoleshente shpesh nuk gjejnë mbështetjen e duhur kur vije puna tek sëmundjet që kanë të bëjnë me shëndetin e tyre të riprodhimit. Sipas vlerësimit të kryer për hartimin e Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë 2017-2021, për vajzat dhe gratë e moshës 15-49 vjeç, shkalla më e lartë e sëmundshmërisë ishte për sëmundjet e sistemit urogjenital me 10.9%. Fatkeqësisht ka mungesë edhe të shërbimeve të specializuara shëndetësore për viktimat të dhunës seksuale, çofshin meshkuj apo femra.

## Hapat e ardhshëm

- Rritja e ndërgjegjësimi për të drejtat e grave dhe mbështetja e viktimave për opsonet jashtë marrëdhënieve të dhunshme në familje.

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të vendosë procedura për të siguruar që të gjithë fëmijët të përfundojnë arsimin e detyrueshëm fillor dhe të mesëm të ulët.
- Ngritja e ndihmave sociale specifike për arsimin. Detyrimet si transporti, uniformat apo librat mund të bëhen barrë për familjet në nevojë. Shteti duhet të punojë në subvencionimin e këtyre detyrimeve në mënyrë që të lehtësojë efektin financiar tek grupet e cënueshme.
- Rritja e fondeve për strehimoret për të mbijetuarit e dhunës në familje. Pasi në Kosovë nuk ekziston asnjë strehimore shtetërore për të mbijetuarit e dhunës, qeveria duhet të rrisë financimin për organizatat jo qeveritare që e ofrojnë këtë shërbim.
- Hendeku i pagave mes femrave dhe meshkujve është një problem global duke e përfshirë Kosovën. Vendi ynë ka nevojë të krijojë Indeksin e Barazisë Gjinore për paga, në mënyrë që të adresohet kjo qështje.





## OZHQ 6: UJË I PASTËR DHE KANALIZIME

*Sigurimi i qasjes në furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjithë*

### Vlerësimi i targeteve


6.1 Qasja në ujë të pijshëm në Kosovë është mjaft gjithëpërfshirëse, duke mbuluar kështu 96.84% të popullsisë me ujë të menaxhuar në mënyrë të sigurt.

### Situata e përgjithshme

Kosova i ka gjithsej 8 lumenjë kryesorë (me degët e tyre) dhe 4 liqene të mëdha (janë edhe disa liqene të tjera po për shkak të sipërfaqes së vogël nuk llogariten nga ASK-ja). Drini i Bardhë ka gjatësi më të madhe në kilometra brenda territorit të Kosovës me 122 km, ndërsa Lumëbardhi i Prizrenit më të vogël me 31 km.<sup>49</sup> Hidrografia e rrjedhave ujore të Kosovës ndahet në 4 pellgje lumore: Drini i Bardhë, Morava e Binçës, Lepenci dhe Ibri. Lumenjët e Kosovës derdhen në 3 ujëmbledhës: Detin i Zi, Detin Adriatik dhe Detin Egje. Në vitin 2003 janë ndërtuar 22 stacione matëse nëpër lumenjë ku kryhen matje të vazhdueshme mbi vëllimin e ujit duke përfshi edhe parametrat fiziko-kimik të lumenjëve. Kjo matje bëhet me anë të sensorëve digjital. Për të plotësuar nevojat e qytetarëve për ujë të pijshëm, ujitje, peshkim, turizëm dhe për prodhimin e energjisë elektrike, në shumë vende janë ndërtuar diga apo

akumulacione për të grumbulluar ujin e përrenjve dhe lumenjëve. Këto akumulacione janë: Gazivoda, Pridvorci, Batllava, Badovci, Livoçi dhe Radoniqi. Sa i përket ujërve nëntokësore, ato nuk janë të shfrytëzuara në nivel shtetëror. Kjo do të thotë që shfrytëzimi i tyre bëhet kryesisht në nivel individual, përmes puseve dhe burimeve. Kosova ka gjithashtu edhe burime të ujërave termale, prej të cilave njihen Banja e Pejës, e Kllokotit, e Banjskës të cilat

Harta e pellgjeve lumore në Kosovë




Burimi: ASK, Hartografi

shërbejnë si banja termale për shërim. Në vitin 2021 rreth 96.88 % e popullsisë së Kosovës është furnizuar me ujë

<sup>49</sup> Përmbledhje e shkurtër e resurseve ujore të Republikës së Kosovës 2020, Autoriteti Rejonial i Pellgjeve Lumore

nëpërmjet sistemit publik të menaxhuara nga Kompanitë Rajonale të Ujit. Ndërsa, 3.16 % e popullsisë nuk ka pasur qasje fare në shërbime të ujësjesit publik.<sup>50</sup>



Sasia ujit të shpenzuar m<sup>3</sup> për banor nga ekonomitë familjare të kyqura në sistemin publik, në vitin 2020 ishte: 2.54 m<sup>3</sup> në muaj dhe 0.08 m<sup>3</sup> në ditë. Kurse llogaritur në litra ishte: 84.67 litra/ditë për banor. Trajtimi i ujërave në Kosovë bëhet vetëm në impiantin e ujërave të zeza në Skenderaj. Ujërat e zeza në komunat tjera të Kosovës shkarkohen direkt në rrjedhat lumore, gjë që ndikon shumë në ndotjen e ujërave sipërfaqeësore në vend. Për impiantet për trajtimin e ujërave të zeza që janë në ndërtim në komuna tjera ende nuk ka të dhëna për sasinë e ujërave të zeza të shpenzuar.<sup>51</sup>

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë



Ligji për ujërat e Kosovës



Ligji për rregullimin e Shërbimeve të ujit



Rregulloret e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e ujit

## Sfidat kryesore

- Ka akoma rajone të Kosovës të cilat vuajnë nga mungesa e ujit dhe cilësia e dobët e ujit të pijshëm. Dendësia relativisht e lartë e popullsisë dhe bujqësia e ujitit tradicionalisht e rrisin akoma më shumë këtë problem.
- Qytetarët duhet të përballen me verat e ngrohta dhe të thata dhe mungesën e trajtimit të ujërave të zeza. Shkaktarë i kësaj gjendje është mungesa e një sistemi eficient dhe efektiv të menaxhimit të ujërave.

<sup>50</sup> Statistikat e Ujërave në Kosovë 2021, ASK

<sup>51</sup> Po aty

- Një tjetër sfidë më të cilën përballet sektori i ujërave në Kosovë janë investimet. Sigurimi i financimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë për investimet në infrastrukturën e menaxhimit të ujërave është kriter kyç për arritjen e pëputhjes së legjislacionit kombëtar me acquis-in e BE-së për këtë sektor.
- Sfida tjetër është inkasimi i parave të kompanive të ujit. Sipas Danube Water Program, nivelet aktuale të tarifave rëndojnë buxhetet e kategorive sociale në disavantazh. Kjo kërcënon qëndrueshmërinë financiare të ujësjellësit, e cila nuk janë në gjendje të mbledh pagesa nga 15% e konsumatorëve rezidencialë që i përkasin atyre kategorive sociale.

## Hapat e ardhshëm

- Ndërtimi i puseve të mundshme të prodhimit për përdorim të ujërave nëntokësore.
- Zhvillimi i një baze të dhënash për menaxhimin e lejeve të nxjerrjes së ujit dhe të dhënave të cilësisë së ujit.
- Zhvillimi i një plani të menaxhimit të përmytjeve, ku përfshihet vlerësimi i dëmeve nga përmytjet dhe strategjitë/mjetet për parandalimin e tyre.
- Rritja e investimeve për përmirësimin e kapaciteve për rritjen e cilësisë së ujit.



## OZHQ 7: ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR

*Sigurimi i furnizimit me energji me kosto të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë*

### Vlerësimi i targeteve

7.1 Ky target nuk është problematik për rastin e Kosovës pasi që ne kemi mbulueshmëri 100% të popullsisë me energji elektrike.


7.2 Pjesëmarrja e energjisë së ripërtrishme në përqindjen e përgjithshme të burimeve të energjisë edhe pse është e vogël, përkatsisht 7.03%, është në trend të rritjes. Ky trend vë në mënyrë të shumtë nga investimet private.

7.B Kosova nuk është e pasur me teknologji moderne për shërbime energjetike. Kapaciteti total i instaluar për gjenerim të energjisë së ripërtrishme për vitin 2021 është 276 MW.

### Situata e përgjithshme

Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë është pothuajse tërësisht i varur nga dy termocentrale të linjitet: Kosova A (5 njësi me 610 MW të instaluar) dhe Kosova B (dy njësi me 678 MW të instaluar). Kapaciteti aktual aktual i këtyre centraleve është rreth 960 MW<sup>52</sup> gjithsej. Këto dy termocentrale furnizohen me linjit nga minierat fqinje të Sibovcit Jugperëndimor dhe Sitnicës. Kosova ka resurse shumë të mëdha të linjitet, me një total prej 12.5 miliardë tonësh,<sup>53</sup> të

cilat renditen të pestat më të mëdha në botë.<sup>54</sup> Përdorimi i madh i qymyrit për prodhim të energjisë elektrike ka bërë që vendi shumë herë të këtë një indeks të lartë të ndotjes së ajrit (Air quality index ose AQI). Përparimi i Kosovës në zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme u pengua për shumë vite nga planet për një termocentral të ri 500 MW me linjit – Kosova e Re – i cili devijoi fokusin nga zhvillimi i formave më të qëndrueshme të energjisë. Kosova është anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe rrjedhimisht ka detyrime që duhet t'i plotësojë. Njëri nga këto obligime është që Kosova deri në vitin 2020, 25% të burimeve të energjisë ti ketë nga




<sup>52</sup> Raporti Vjetor 2021, ZRRE

<sup>53</sup> Departamenti i energjisë dhe minierave, Ministria e Ekonomisë. E qasshme këtu: <https://me.rks.gov.net/sq/energji-dhe-minierat#.Yt-paXZByM8>

<sup>54</sup> Vendburimet Minerale, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. E qasshme këtu: <https://kosovo-mining.org/resurset-minerale/vendburimet-minerale/>

burimet e ripërtëritshme të energjisë.<sup>55</sup> Në kuadër të caktit 25% prej BRE-ve, parashikohet që prioritet të jenë hidrocentralet (240 MW), energjia e erës (150 MW), energjia solare (10 MW), dhe biomasa/biogazi (14 MW). Në vitin 2020 Kosova e ka arritur cakun prej 25% të pjesëmarrjes së BRE. Për ndërtimin e hidrocentraleve të reja duhet të bëhet një analizë e mirëfilltë e fizibilitetit ekonomik dhe e dëmeve që ato hidrocentrale mund të shkaktojnë në florën dhe faunën e zonave ku ato ndërtohen. Në vendin tonë shumica e hidrocentraleve ekzistuese janë hidrocentrale pa liqene akumuluese dhe pa rezervuare të mëdha, përveç HC Ujmanit. Shumica e hidrocentraleve janë të llojit të vogël që shfrytëzojnë rrjedhën e ujit dhe përdorin tubacione të gjata.<sup>56</sup> Hidrocentralet kryesore të vendit janë: Ujmani (35 MW), Lumbardhi 1 (8 MW) dhe Lumbardhi 2 (7 MW), HC Deçani (9,5 MW), HC Belaja (7,5 MW), HC Brodi 1 & 2 (4.7 MW + 1MW), HC Albaniku 2 (4 MW), HC Restelica 1 & 2 (2.4 MW), HC Dikanci (3 MW), etj.<sup>57</sup> Por në krahasim me vendet fqinje, si p.sh. Shqipëria, Kosova ka një potencial të pamjaftueshëm për prodhimin e energjisë elektrike përmes

hidrocentraleve, për shkak të relievit dhe klimës. Sipas të dhënave nga ASK, vetëm 1% e burimeve të përgjithshme të energjisë së prodhuar është nga energjia hidrike.



Konsumin më të madh të energjisë elektrike e ka sektori i amvisërisë (59%), i ndjekur nga shërbimet (21%), industria (18%), dhe bujqësia (2%). Energjia, e cila konsumohet nga sektori i amvisërisë shfrytëzohet për ngrohjen e hapësirave, kondicionimin e ajrit, ngrohjen e ujit sanitar, gatim, ndriçim dhe përdorim të pajisjeve elektrike për nevoja familjare dhe individuale. Në vitin 2021 konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike ka qenë 486.56 ktoe, në krahasim me vitin 2020 ka pasur ngritje prej 17.49 %.<sup>58</sup>


<sup>55</sup> Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (PKVBRE) 2011-2020

<sup>56</sup> Hidrocentralet në Kosovë problemet dhe potenciali i tyre real, BGF dhe INDEP

<sup>57</sup> KOSTT (2018), Kapacitetet e Instaluar të Energjisë Elektrike në Kosovë. (Kapaciteti i Njësive të Gjenerimit, Sektori i Planifikimit Afatmesëm)

<sup>58</sup> Balanca Vjetore e Energjisë 2021, ASK

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë




Ligji për energjinë



Ligji për efikasitet të energjisë




Ligji për energjinë elektrike



Ligji për energjinë termike

## Objektivat e Draftit të Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031



## Sfidat kryesore

- Për shkak të përdorimit të madh të qymyrit për prodhim të energjisë elektrike, Kosova ka problem me ndotjen e ajrit, sidomos gjatë stinës së dimrit. Zonat me indeks të lartë të ndotjes së ajrit janë cilësuar Kaçaniku, Ferizaji, Vushtrria dhe Mitrovica. Cilësia e ajrit gjatë vitit 2020 është cilësuar si mesatar.
- Ndonëse Kosova ka resurse të mëdha energjetike të qymyrit, furnizimi me energji elektrike nuk është stabil. Kjo vije si pasojë e mungesës së investimeve në ndërtimin e kapaciteteve të reja apo të përmirësimit të kapaciteteve ekzistuese. Për më tepër teknologjia ekzistuese e kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike nuk plotëson kriteret mjedisore të përcaktuara nga legjislacioni i BE-së.
- Një tjetër sfidë që është ka ardhur në shprehje akoma më shumë gjatë muajve të

fundit është mungesa e investimeve në sistemin e rrjetit të shpërndarjes, i cili nuk po mundet t'i përballojë kërkesat për furnizim gjatë stinës së dimrit.

- Në ndërkohë, shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë dhe dërgimi i një sasive të konsiderueshme të energjisë elektrike në disa komuna në veri të Kosovës, ku OSSH-ja dhe Ndërmarrja e furnizimit, nuk kanë kontroll paraqet problem shumë të madh sepse kjo energji nuk faturohet dhe barra iu bije qytetarëve të tjerë që jetojnë jashtë atyre zonave.
- Si pasojë e mungesës së alternativave të tjera, burimi kryesor i ngrohjes mbetet energjia elektrike. Për këtë arsye amvisëria është sektori i cili shfrytëzon më së shumti energjinë elektrike. Fatkeqëshit energjia elektrike e gjeneruar nga BRE-të vazhdon të mbetet e ulët në konsumin e përgjithshëm në konsumin e energjisë elektrike. Kjo mbetet sfida kryesore për vitet e ardhshme në sektorin e energjisë në Kosovë.

## Hapat e ardhshëm

- Hartimi i strategjive të reja duhet të ketë fokus kryesor mjedisin dhe të rivlerësohet potenciali i burimeve të ripërtëritshme për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë.
- Ndërtimit të hidrocentraleve të reja t'i paraprijnë analiza të thelluara, ku merren parasysh standardet mjedisore e evropiane. Këto duhet të publikohen për shkaqe të transparencës.
- Projektet dhe planet energjetike në Kosovë duhet të kenë në fokus burimet e erës dhe ato solare, sepse këto të dyja kanë potencial shumë të madh në Kosovë, i cili deri tani ka mbetur i pashfrytëzuar.
- Rritja e koordinimit të punës dhe politikave mes akterëve institucional në nivelin lokal dhe qendror në mënyrë që projektet dhe strategjitë të arrijnë maksimizim të rezultateve.



## OZHQ 8: PUNË DINJITOZE DHE RITJE EKONOMIKE

*Nxitja e rritjes ekonomike të pandërprerë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimin të plotë e produktiv dhe punës së denjë për të gjithë*

*gjithë*

### Vlerësimi i targeteve

8.1 Norma vjetore e rritjes së PBB për kokë banori gjatë vitit 2021 ka pasur rritje në 8.15%, krahasuar me vitin 2020 që kishte rënie -5.41%.<sup>59</sup>

8.5 Shkalla e papunësisë në Kosovë është në nivel më të lartë tek femrat deri në moshën 45 vjeçare, kurse pas moshës 45 vjeçare shkalla e papunësisë rritet tek gjinia mashkullore.

8.6 Numri i të rinjve që nuk janë të përfshirë në punësim, arsimim apo trajnime profesionale fatkeqësisht ka një trend të rritjes që nga viti 2017.

8.7 Pjesëmarrja e fëmijëve në punë është një dukuri ende e pranishme në vendin tonë. Në vitin 2020 nga Inspektoriati i Punës janë regjistruar 5 fëmijë të punësuar.


8.8 Lëndimet në punë kanë qenë evidente edhe gjatë vitit 2021. Lëndimet fatale janë përgjysmuar krahasuar me vitin 2020, por lëndimet jo fatale janë rritur gjatë vitit 2021.

8.10 Në sektorin financiar, bankat komerciale në vend gjatë vitit 2020 u rriten. Poashtu edhe numri i terminaleve

të ATM që nga viti 2018 deri në vitin 2021 ka pësuar një trend të rritjes.

### Situata e përgjithshme

Gjatë 10 viteve të fundit për herë të parë në vitin 2020 PBB ka pësuar rënie në vlerë negative -5.41%. Pas pandemisë COVID-19, rritja ekonomike e Kosovës është rikthyer më shpejtë se që pritej, kryesisht falë remitancave të diasporës. Pasojat nga humbjet e vendeve të



punës nga pandemia kanë prekur në mënyrë disproporcionale gratë dhe të rinjtë, gjë që mund të ngadalësoj rrijen e shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore.

Sipas ASK-së, bruto produkti vendor (BPV) në tremujorin e katërt të 2021

<sup>59</sup> World Development Indicators, Banka Botërore. E qasshme këtu:


<https://databank.worldbank.org/reports.aspx?source=world-development-indicators>



shënon rritje reale për 6.36%, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak.<sup>60</sup>

Shkalla e punësimit për vitin 2020 ishte 28.4%. Punësimi me i lartë është vërejtur te meshkujt 42.8%, ndërsa punësimi te femrat ishte 14.1%. Femrat ishin të punësuar, kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor, me 52.7%, ndërsa meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë dhe prodhimit me 44.1%. Sektorët ekonomikë, që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë: tregtia me 17.0%; prodhimi me 11.8%; ndërtimtaria me 11.1%; dhe arsimi me 10.1%. Ndërsa, sektorët e tjerë marrin pjesë me përqindje më të vogël në punësim. Sa i përket të punësuarve me kontrata, del se 42.3% e personave të punësuar kanë kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 57.7% kanë kontratë të përkohshme. Në vitin 2020, shkalla e papunësisë ishte 25.9%. Papunësia më e theksuar ishte te femrat me 32.3%, krahasuar me meshkujt, 23.5%. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24 vjeçare me 49.1%. Në vitin 2020, fuqia joaktive ishte mjaft e lartë me 61.7%, me fokus të veçantë te femrat me 79.2 %,

krahasuar me meshkujt, 44.0%.<sup>61</sup>




Niveli i pagës mesatare në Kosovë krahasuar me vitin 2020, në vitin 2021 është ngritur. Në sektorin publik paga mesatare u zvogëluar, përkundër sektorit privat dhe ndërmarrjeve publike ku paga mesatare u ngrit.

Pavarësisht ndryshimit të standardit jetësor përgjatë viteve, numri i familjeve me asistencë sociale ka mbetur pothuajse i njëjtë. Sipas legjislacionit të Kosovës, për të përfutur ndihmën sociale të gjithë anëtarët e familjes duhen të jenë banorë të përhershëm të Kosovës. Skema e ndihmës sociale "ka për qëllim për të ndihmuar financiarisht familjet, anëtarët e të cilëve janë ose me aftësi të kufizuara të përhershme ose në moshën mbi 65 vjeçare, si dhe për familjet të cilët kanë vetëm një apo asnjë familjar të punësuar dhe i kanë të hyrat nën standardin e caktuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale".

Një fenomen shumë shqetësues është përqindja e të rinjëve (të moshës 15-24 vjeç) që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim. Që nga viti 2016 kjo përqindje ka filluar të rritet.

<sup>60</sup> Bruto produkti vendor BPV me qasjen e shpenzimeve dhe te prodhimit TM4 2021, ASK

<sup>61</sup> Anketa e Fuqisë Punëtore 2020, ASK



Sipas raportit të OECD-së "Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore", të arriturat kryesore të Kosovës në fushën e rritjes ekonomike janë:

- Nga të gjitha ekonomitë e vlerësuara nga Indeksi Rregullator i Kufizimit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) të OECD-së, Kosova është një nga ekonomitë më pak kufizuese ndaj IHD-ve.
- Kosova është ekonomia më pak kufizuese në WB6 (Western Balkan 6) për tregtinë e

shërbimeve dhe një nga ekonomitë më tërheqëse për ofruesit e shërbimeve të huaja, gjithashtu në mesin e të gjitha ekonomive të vlerësuara nga projekti i OECD STRI.

- Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) unifikon mbledhjen e taksave dhe të gjitha funksionet kryesore të administratës tatimore. Ai gjithashtu mbikëqyr vlerësimin e pajtueshmërisë tatimore dhe menaxhimin e rrezikut duke përdorur një analizë të bazuar në rrezik duke i ofruar ATK-së një autonomi të plotë operacionale brenda Ministrisë së Financave.
- Shkalla e braktisjes së hershme të shkollës ra nga 18.4% në 2013 në 9.6% në 2018, duke arritur objektivin e BE-së për vitin 2020 prej më pak se 10%.<sup>62</sup>

<sup>62</sup> Konkurrueshmëria dhe Zhvillimi i Sektorit Privat, OECD Library. E qasshme këtu: <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/dcbc2ea9->

<en.pdf?expires=1659006712&id=id&accname=guest&checksum=6F09A14220B42A950B81EA754232C059>


## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë



Ligji i Punës



Ligji për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme




Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara



Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti



Ligji për Agjencinë e Punësimit



Ligji për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve për të papunët, punëkërkuarit dhe punëdhënësit



Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë

## Sfidat kryesore

- Papunësia e lartë e të rinjve, duke krijuar probleme të rënda me tranzicionin shkollë-punë.
- Mospërputhja e aftësive që mësohen në insitucione arsimore më kërkesat e tregut të punës.
- Financimi i ulët publik për zhvillim të hulumtimeve dhe zhvillimin e kapacitetit të inovacionit.
- Puna jo-formale dhe kontratat e parregullta po e vështirësojnë përmirësimin e kushteve të punës.
- Nxitje dhe përkrahje jo e mjaftueshme ndaj grave në sektorin e ndërmarrësisë.

## Hapat e ardhshëm

- Draftimi i strategjive dhe planeve për uljen e papunësisë.
- Harmonizimi i kurrikulave shkollore me aftësitë e kërkuara në tregun e punës.
- Draftimi i politikave të mbështetjes së punësimit.
- Krijimi i programeve për mbështetjen ndaj grave në sektorin e ndërmarrësisë.
- Draftimi i politikave dhe strategjive të reja për mbështetjen dhe tërheqjen e investimeve të huaja.



## OZHQ 9: INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË

*Ndërtimi i një infrastrukture rezistuese, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe promovimi i inovacionit*

### Vlerësimi i targeteve

9.1 Qasja e pupullsisë në transport publik nuk matet në Kosovë. Mirëpo numri i pasagjerëve të transportit hakurudhor ishte 58.82 mijë në vitin 2021, kurse numri i pasagjerëve të transportit ajror është dyfishuar në këtë vit krahasuar me vitin 2020.<sup>63</sup>

9.2 Sektori i prodhimit në Kosovë paraqet 13.4% të PBB. Në vitin 2021 janë regjistruar 12.4% të punësuar në prodhim krahasuar me punësimin në përgjithësi.

9.C Sipas anketës së përdorimit të teknologjisë informative dhe komunikimit në Kosovë në vitin 2021 96.1% e ekonomive familjare kanë qasje në internet.

### Situata e përgjithshme

Punësimi në industrinë prodhuese si përqindje e punësimit total është mjaft i ulët në Kosovë, varion nga 10% deri në 15%. Duke u bazuar në të dhënat nga ASK-ja, në vitin 2020 në industrinë prodhuese ishin punësuar vetëm 11.8 % ndaj punësimit total, kurse në tre mujorin e parë të vitit 2021, 12.4%.<sup>64</sup> Banka Botërore parashikonte që gjatë pandemisë BPV-ja në shtetet europiane

do të kishte rënie mbi 3.4%,<sup>65</sup> por deri në fund të vitit 2020 Kosova kishte arritur të kufizonte rënien e BPV së saj në vetëm 5.3%.<sup>66</sup> Partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës janë vendet e BE-së (44.3% e importeve dhe 31.5% e eksporteve), dhe shtetet fqinje të Ballkanit Perëndimor, me të cilat Kosova tregton pa tarifa sipas kushteve të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA).<sup>67</sup>

Pavarësisht sfidave si papunësia e lartë apo ekonomia informale, popullësia relativisht e re e Kosovës, kostot e ulëta të punës dhe burimet natyrore kanë tërhequr disa investime të rëndësishme dhe disa firma ndërkombëtare. Investimet në vitin 2021 kanë pasur një rritje prej 10.2%, dhe investimet e huaja janë dyfishuar nga janari deri në shtator të po të njëjtit vit. Vlerat totale të këtyre investimeve kanë arritur në 4 milionë e 655 mijë euro. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore 3 vendet të cilat kanë investuar më së shumti në Kosovë gjatë vitit 2021 ishin: Gjermania, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Zvicrra.<sup>68</sup> Stimulimi i ekonomisë inovative qarkore dhe konkurruese, dhe ndërtimi i infrastrukturës cilësore, të qëndrueshme dhe të integruar janë dy shtyllat kryesore të Strategjisë

<sup>63</sup> Statistikat e transportit, ASK.

<sup>64</sup> Anketa e Fuqisë Punëtore TM1 2021, ASK

<sup>65</sup> The Potential Impact of COVID-19 on GDP and Trade, Banka Botërore

<sup>66</sup> Statistikat e Llogariva Kombëtare, ASK

<sup>67</sup> Statistikat e Tregtisë së Jashtme 2021, ASK

<sup>68</sup> Raporti Vjetor 2021, Banka Qendrore e Kosovës

Kombëtare për Zhvillim. Në vitin 2021 numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 10,649 ose 8.6% më shumë se vitin paraprak, ndërsa 1,608 ndërmarrje u mbyllën apo 21.3 përqind më shumë sesa në vitin e kaluar.<sup>69</sup>

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara pësoi rritje në sektorët të cilët janë ndikuar nga masat e pandemisë në vitin 2020. Ndër këta sektorë hyjnë tregtia hoteleria dhe aktivitetet profesionale.


Që ndërmarrjet t'i plotësojnë kapacitetet e tyre në plota, në mes të shumë faktorëve të tjerë, është e nevojshme infrastruktura. Furnizimi i ndërmarrjeve me energji elektrike, ujë dhe shërbime të tjera janë vetëm disa nga nevojat bazike për funksionimin e ndërmarrjeve. Në aspektin e infrastrukturës rrugore Kosova ka infrastrukturë rrugore dhe

ajrore të zhvilluar. Në korrik të vitit 2022 Kuvendi i Kosovës miratoi projektligjin për hekurudhën për lidhjen hekurudhore Durrës-Prishtinë.<sup>70</sup>

Poashtu në kryeqytetin e Kosovës, oraret dhe rrugët e linjave të autobusëve urban mund të përcillen përmes aplikacionit "Trafiku Urban". Mirëpo tani Prishtina është qyteti i parë në rajon që linjat e autobusëve urban i shfaqen në Google Maps.

Në Kosovë promovohet inovacioni përmes qendrave si Innovation Centre Kosova, që është një hapsirë ku njerëzit mund të trajnohen dhe të gjejnë mënyra të financimit për biznesin që duan të nisin. Ngjashëm kontribuojnë edhe Jakova Innovation Center dhe UNICEF Innovation Lab Kosovo.


## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë



Ligji për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë



Ligji për dizajnin industrial



Ligji për hekurudhat e Kosovës

## Sfidat kryesore

- Njëra ndër pengesat kryesore për zhvillimin e sektorit të industrisë është furnizimi me energji elektrike, i cili është i paqëndrueshëm dhe i kushtueshëm. Termocentralet Kosova A dhe B kanë një kapacitet të përbashkët të instaluar prej vetëm 1478 MW, mirëpo për shkak të vjetërsisë së tyre dhe

<sup>69</sup> Raporti i Stabilitetit Financiar, BQK

<sup>70</sup> Kuvendi i Kosovës, korrik 2022. E qasshme këtu: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=393>

operimit me teknologji jo efikase, kapaciteti i tyre operativ është diku rreth 915 MW. Si pasojë e pamjaftueshmërisë së energjisë, Kosova detyrohet të importojë energji nga vendet e tjera. Kostoja e importit është shumë e lartë dhe si rrjedhojë edhe çmimi i energjisë për konsumatorët e rëndomtë dhe bizneset është i lartë.

- Vetëm 56% të infrastrukturës rrugore të Kosovës është e shtruar me asfalt (akset kryesore nacionale). Në anën tjetër, rrjeti hekurudhor ka rreth 330 km, por me infrastrukturë të vjetruar. Duke qenë se distancat mes vendeve në Kosovë janë të shkurtra, këto dy forma të transportit do të mjaftonin për të plotësuar kërkesat e tregtisë së mallrave brenda vendit. Mundësia për transport më të shpejtë dhe më të lirë do t'ju ndihmonte të gjitha industrive të Kosovës për t'i siguruar më lirë lëndët e para dhe rrjedhimisht çmimet e produkteve në treg të ishin më të lira.
- Ndërkohë që qasja në internet në shtëpitë private është rritur, në institucione publike kjo gjë ka stagnuar. Ky stagnim e kufizon cilësinë e shërbimeve të shtetit dhe efikasitetin e institucioneve, sepse e rrit koston e shërbimeve dhe nuk është efiçiente në kontekstin e kohës. Për shembull, shkollat rurale, bibliotekat, institucionet shëndetësore, etj., nuk e kanë të inkooporuar digjitalizimin e tyre. Një përmirësim është vërejtur gjatë vitit 2020 në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani", ku është bërë digjitalizimi i disa shërbimeve, por jo të gjithave. Këtë shembull duhet ta ndjekin edhe institucionet e tjera.

## Hapat e ardhshëm

- Përmirësimi i infrastukturës së termocentraleve, duke iu përshtatur standardeve të BE-së, ose përdorimi i burimeve të tjera të ripërtritshme bashkë me ndërtimin e infrastrukturës përkatëse.
- Integrimi i tregut të energjisë me tregun rajonal të energjisë.
- Fuqizimi dhe mbështetja e Fondit për Efiçencë të Energjisë dhe implementimi funksional i tij.
- Modernizimi dhe zgjerimi i linjës së vetme ndërkombëtare hekurudhore në Kosovë.
- Mbështetja e ndërmarrjeve vendore në fushën e TI-së.
- Rritja e kapacitetet përpunuese të industrisë ushqimore në mënyrë që sa më pak të ketë humbje të prodhimeve bujqësore.



## OZHQ 10: ZVOGËLIM I PABARAZIVE

*Ulja e pabarazive përbrenda dhe ndërmjet vendeve*

### Vlerësimi i targeteve

10.3 Sipas të dhënave të mbledhura nga burime të ndryshme nga UN 11.4% e popullsisë raporton se janë ndjerë personalisht të diskriminuar ose të ngacmuar brenda vitit 2020.

10.4 Pagat dhe mëditjet marrin pjesë me 12.5% në vlerën totale të Bruto Produktit Vendor, sipas buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2022.

10.5 Treguesit e qëndrueshmërisë financiare në Kosovë publikohen në baza vjetore nga Banka Qëndrore e Kosovës. Në vitin 2021 Asetet likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (37.43%); Asetet e kapitalit rregullator të nivelit 1 të ponderuara (13.60%); Kapitali rregullator ndaj asetëve (9.28%); Pozicioni i hapur neto në kapitalin valutor (3.32%); Kthimi në asete (2.38%); Kreditë me probleme ndaj totalit të kredive bruto (10.14%).<sup>71</sup>

10.6 Pjesëmarrja e Kosovës në organizata ndërkombëtare International Finance Corporation (0.54%); International Bank for Reconstruction & Development (0.53%); International Monetary Fund (0.53%).<sup>72</sup>

10.7 Kosova ndër vite ka miratuar politika migracioni që lehtësojnë migrimin dhe lëvizshmërinë e rregullt, të sigurt, të rregullt dhe të përgjegjshëm të njerëzve. Këtu vlen të përmendet ligji për azil dhe ligji për të huajt.

10.A Shumica absolute e mallërave të cilat importohen në Kosovë, të cilat janë pajisje bujqësore janë të liruar nga obligimet doganore deri sa për ndërtimtari mallërat të cilat vijnë nga vendet e CEFTA-s paguajnë kryesisht 18% TVSH-ë deri sa nga vendet tjera paguajnë obligimet e plota (10% takse doganore dhe 18% TVSH).

10.C Në vitin 2021 vlera e remitancave sipas BQK arritit shumë të shumta të përpiluara nga OKB. Të qasshme këtu: [https://ourworldindata.org/grapher/proportion-of-members-of-developing-countries-in-international-organizations?country=-OWID\\_KOS](https://ourworldindata.org/grapher/proportion-of-members-of-developing-countries-in-international-organizations?country=-OWID_KOS)

### Situata e përgjithshme

Pabarazia në rritje ekonomike mes vendve ka ndikuar që fenomeni i pabarazisë të reflektohet edhe brenda vet këtyre vendeve, gjë e cila shkaktohet nga diferenca e madhe në të ardhura. Kjo pabarazi në Kosovë është vazhdimisht në rritje, e cila mund të rezultojë në zhdukjen e klasës së mesme.

Norma mesatare vjetore e inflacionit në


<sup>71</sup> Të dhëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Të qasshme këtu:

[https://ourworldindata.org/grapher/regulation-financial-markets?country=-OWID\\_KOS](https://ourworldindata.org/grapher/regulation-financial-markets?country=-OWID_KOS)

<sup>72</sup> Të dhënat nga burime të shumta të përpiluara nga OKB. Të qasshme këtu:

[https://ourworldindata.org/grapher/proportion-of-members-of-developing-countries-in-international-organizations?country=-OWID\\_KOS](https://ourworldindata.org/grapher/proportion-of-members-of-developing-countries-in-international-organizations?country=-OWID_KOS)

vitin 2021 ishte 3.4%.<sup>73</sup> Kurse paga mesatare neto në vitin 2021 ishte 432 Euro, krahasuar me vitin 2020 e cila ishte 416 euro, një rritje prej 3.84%.<sup>74</sup> Sipas Bankës Botërore, Koeficienti Gini gjatë vitit 2017 ishte 29.0. Krahasuar me vendet fqinje, si për shembull Serbinë (36.2), Maqedoninë e Veriut (33.6) ose Malin e Zi (36.9), Kosova qëndron më mirë sa i përket shpërndarjes së të ardhurave.<sup>75</sup> Që nga viti 2017 nuk ka pasur më matje të koeficientit Gini në Kosovë.




Shkaqet kryesore të pabarazisë ekonomike në Kosovë, e poashtu edhe në rajon, janë përjashtimi nga tregu i punës ose puna me pagë të ulët. Faktorët si puna jo-formale, puna pa kontratë ose me kontratë jo të rregullt, puna me orare jo të rregullta, ndikojnë në rritjen e pabarazisë.

Diskriminimet në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike, moshës e aftësisë trupore, janë të pranishme në vendet e punës. Sipas një hulumtimi të bërë nga Institutit Riinvest në vitin 2017, më shumë se një në dhjetë gra të punësuarra të anketuara kishin përjetuar diskriminim me bazë gjinore në punë.<sup>76</sup>

<sup>73</sup> Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), 2021, ASK

<sup>74</sup> Vjetari Statistikor 2022, ASK

<sup>75</sup> World Development Indicators, Banka Botërore. E qasshme këtu: <https://databank.worldbank.org/source/world-development-indicators>



Romët nga ana tjetër kanë më shumë gjasa të jenë të papunë, të fitojnë paga më të ulëta dhe punë në sektorin informal se sa jo-romët. Të prekur nga diskriminimi strukturor janë edhe grupet e personave me aftësi të kufizuara. Edhe pse ekziston ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, praktikat në jetën reale nuk e zbatojnë gjithmonë këtë ligj.

Në fushën e mbrojtjes sociale, skemat e mbrojtjes sociale nuk i mbrojnë individët nga rreziku i papunësisë sepse Kosova nuk ofron asistencë papunësie. Mungesa e aksesit në arsim cilësor është gjithashtu bazë për krijimin e pabarazive. Për shembull, fëmijët e prindërve me nivele më të ulëta arsimore ose financiare, janë më në rrezik nga varfëria ose përjashtimi social. Personat me aftësi të kufizuara gjithashtu shpesh përballen me rrezikun e përjashtimit nga arsimi, ose ata mund të ndahen në programe të veçanta, ose ndjekin programe të orientuara drejt profesioneve të caktuara.

Një lloj pabarazie ekziston edhe mes zonave rurale dhe atyre urbane. Kjo për faktin se zonat rurale në Kosovë nuk janë të zhvilluara sa duhet, përveç

<sup>76</sup> Gratë në Tregun e Punës, Analizë e Kushteve të Punës për Gratë në Kosovë, 2017. E qasshme këtu: [https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Grate\\_ne\\_tregun\\_e\\_punes1510308263.pdf](https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Grate_ne_tregun_e_punes1510308263.pdf)



sektorit të bujqësisë. Të gjithë sektorët e tjerë si ata të shërbimeve, shëndetësisë, arsimit, kulturës, etj., janë përqendruar kryesisht në zonat urbane, duke i lënë kështu zonat rurale të përjashtuara. Shkallët e varfërisë dhe të varfërisë së

skajshme janë më të larta në vendbanimet rurale.<sup>77</sup> Për shembull në vitin 2015, varfëria në zonat rurale ishte 18.9% krahasuar me 15.5 përqind në zonat urbane dhe 65.7 përqind e të varfërve banonin në zonat rurale.

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë



Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi



Ligji për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhersh'



Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti



Ligji për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës



Ligji për mbrojtjen e fëmijës

## Sfidat kryesore

- Sfida kryesore në uljen e pabarazive në Kosovë është papunësia e lartë aktuale dhe të ardhurat e ulëta të individëve.
- Përjashtimi ose diskriminimi ndaj grupeve të caktuara nga nivelet e larta të edukimit (p.sh. romët ose personat me aftësi të kufizuara).
- Moszbatimi i plotë i ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Mospërputhja mes aftësive dhe njohurive që zhvillohen në institucione shkollore dhe aftësive që kërkohen në tregun e punës.

## Hapat e ardhshëm

- Përfaqësim të përmirësuar të punëtorëve në qeverisjen e korporatave.
- Hartimi i Strategjisë për barazi dhe jo-diskriminim.
- Krijimi i skemave për asistencë të papunësisë.
- Përmirësimi dhe hartimi i politikave aktive të tregut të punës, për të rritur

<sup>77</sup> Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës Maj 2019, Banka Botërore

punësimin e grave, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, pakicave etnike dhe personave me nivele të ulëta arsimore.

- Hartimi i politikave për të inkurajuar bizneset që të regjistrojnë të punësuarit e tyre në mënyrë që të zvogëlohet numri i të punësuarëve në ekonominë jo-formale.



## OZHQ 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME

*Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, të forta e të qëndrueshme*

### Vlerësimi i targeteve

11.5 Në Kosovë nuk ka të dhëna për personat e zhdukur ose të prekur nga fatkeqësitë, mirëpo numri i vdekjeve që i atribuohet fatëkeqësive sipas ASK në vitin 2019 ishte 103.

11.6 Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare deri në fund të vitit 2020 në nivel vendi qëndron në 85.3%. Në total, sasia e mbeturinave komunale e deponuar në deponitë sanitare shkon në 446,332.36 ton/vit.

Në aspektin e cilësisë së ajrit në Kosovë gjatë vitit 2021 ndotja mesatare me grimca PM10 ka qenë 23.25, kurse ndotja me grimca PM2.5 ishte 16.64.<sup>78</sup>

11.A Në vendin tonë 36 komuna kanë plane zhvillimore komunale. Planet Zhvillimore Komunale gjenden në webfaqet e komunave.


11.B Strategjia për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe Plani i veprimtimit 2016 – 2020 është në përputhje me Kornizën Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015–2030.

### Situata e përgjithshme

Zakonisht shkalla e urbanizimit është indikatorë për zhvillim ekonomik. Kështu shkalla më e lartë e urbanizimit i përgjigjet shkallës më të lartë të

zhvillimit ekonomik dhe e kundërta. Në intensitetin e urbanizimit ndikojnë rritja e shpejtë e popullsisë, ndryshimet në strukturën ekonomike, migrimet etj. Ndryshime të tilla, të dukshme, ndodhën në Kosovë pas vitit 1999. Sistemi arsimor, shëndetsor, industria, dhe ngritja e administrës, të gjitha u përqendruan në zonat urbane. Si pasojë e kësaj, punëtorë të kualifikuar për të punuar në këto sfera u zhvendosën nga fshati në qytet.

Regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë është bërë në vitin 2011. Sipas të dhënave nga ky regjistrim, rreth 40% jetojnë në zona urbane, ndërsa rreth 60% jetojnë në zonat rurale.



Nga regjistrimi i fundit ka kaluar një dekadë, dhe kjo përqindje e urbanizimit mund të ketë ndryshuar. Në zonat rurale ka mbetur kryesisht popullësia e moshës më të shtyrë, dhe duke e parë trendin e lëvizjes së popullsisë së re, fshatrat në vitetet e ardhshme mund të mos kenë ardhje të kësaj grupmoshe. Korniza ligjore në Kosovë i obligon institucionet e qeverisë për të realizuar

<sup>78</sup> Raporti Vjetor i Ajrit 2021, AMMK


të drejtën për banim adekuat. Ligji për financimin e projekteve të veçanta të banimit (Ligji për banim) u miratua në vitin 2010 me qëllim të sigurimit të qasjes në banim adekuat për ata që nuk mund ta përballojnë një të tillë. Korniza ligjore përcakton se sigurimi i banimit social është përgjegjësi e nivelit komunal, ndërsa Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor është organi përgjegjës për mbikëqyrjen e Ligjit për banim.

Migrimi pas konfliktit solli shumë njerëz në qytete në kërkim të vendeve të punës, kushteve më të mira të jetesës dhe mjedisit më të sigurt. Një numër i madh i qytetarëve të Kosovës udhëtojnë çdo ditë në qytete nga zonat rurale për punë, arsim ose shërbime. Që atëherë Kosova është duke u përballur me një vrull të paparë ndërtimor, me rritje të zonave urbane dhe me një degradim të vazhdueshëm të mjedisit.

Në aspektin e qasjes në transport publik, Kosova bazohet në një infrastrukturë të vjetëruar. Linja hekurudhore funksionale në Kosovë lidh vetëm Prishtinën me

Pejën dhe Fushë Kosovën me Hanin e Elezit,<sup>79</sup> pra ka nevojë për investime në mënyrë që të zgjerohet ky rrjet. Në anën tjetër transporti rrugor përmes autobusëve mundëson një qasje më të gjerë të qytetarëve. Transporti ndërurban i autobusëve lidh pothuajse të gjitha regjionet e mëdha të Kosovës me linja direkte, kurse zonat rurale kanë qasje me linja të ndërlidhura.

Në vitin 2021 nga gjithsejtë 2,432.40 km rrugë, 2,345.86 km apo shprehur në përqindje 96 % janë rrugë të asfaltuara, ndërsa 81 km apo 4% e rrugëve janë të pa asfaltuara. Nga viti 2005 kur nuk kishte fare autoudhë tani ka arritur në 137,15 km gjatësia e autoudhës në Kosovë.<sup>80</sup> Pra nga kryeqyteti i vendit pikat kufitare të vendeve fqinje, Shqipëri, Maqedoni e Veriut dhe Serbi, janë në distancë më të vogël se 2 orë.



<sup>79</sup> Transporti i Udhëtarëve, Trainkos. E qasshme këtu: <https://www.trainkos.com/sherbimet/transporti-i-udhetareve/>

<sup>80</sup> Statistikat e transportit 2021, ASK

Ministria e Infrastrukturës gjithashtu ka publikuar edhe Strategjinë Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Planin i veprimit 5 vjeçar, e cila shtjellon objektivat strategjike dhe operacionale të Ministrisë së Infrastrukturës për krijimi e një sistemi modern dhe të integruar të shërbimeve të transportit, duke i rritur kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore të transportit.<sup>81</sup>

Strategjia Kombëtare Për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027 si qëllim të përgjithshëm e ka promovimin e vlerave reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës si dhe përmirësim e mekanizmave për mbrojtjen e këtyre vlerave. Mirëpo akoma mungon implementimi i masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

### Ligjet që përfshijnë këtë objektivë



Ligji për transportin rrugor



Ligji për trashigimi kulturore



Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura



Ligji i ndërtimit



Ligji për liritë fetare



Ligji për mbrotjen e mjedisit

### Sfidat kryesore

- Mungesa e financimit apo financimi i ulët iu pamundëson komunave që të përmirësojnë performancën e tyre në kuadër të ruajtjes së ambientit.
- Mungesa e infrastrukturës shëndetsore dhe rrugore në zonat rurale për ofrim sa më efikas të shërbimeve.
- Si rezultat i migrimit, popullësia rurale ka humbur në masë të madhe dy kategori të rëndësishme të shoqërisë, të kualifikuarit dhe ata që krijojnë vende të reja pune, duke i lënë fshtarat me jetë të kufizuar sociale.
- Mospërputhja e rregulloreve komunale me dispozitat e kornizës aktuale ligjore për banim social.

<sup>81</sup> Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plan i veprimit 5 vjeçar, Ministria e Infrastrukturës. E qasshme këtu: <https://www.mit->

[ks.net/repository/docs/2017\\_01\\_19\\_081423\\_2015\\_12\\_07\\_081434\\_Strategjia\\_STMM\\_MI\\_14Gusht\\_e\\_korigjuar.pdf](https://ks.net/repository/docs/2017_01_19_081423_2015_12_07_081434_Strategjia_STMM_MI_14Gusht_e_korigjuar.pdf)

## Hapat e ardhshëm

- Krijimi i kushteve të favorshme për zonat rurale, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve të stafit për shërbime si dhe kapacitetet infrastrukturore.
- Investime në infrastrukturën hekurudhore dhe rrugore për ngritje të qasjes së barabartë në transport publik.
- Hartimi i një Plani të Veprimit për rritjen e kapaciteteve të komunave për implementimin e projekteve në lidhje me ruajtjen e ambientit dhe zonave të veçanta.
- Themelimi i Muzeut Arkeologjik, Etnologjik dhe Historisë së Natyrës.
- Draftimi i një Plani të ri për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.



## OZHQ 12: KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM

*Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit*

### Vlerësimi i targeteve

12.4 Në Kosovë, akoma nuk ka asnjë depo ose impiant ekskluziv që do të trajtonte apo të ruante mbeturinat e rrezikshme sipas standardeve të BE.

12.5 Sipas anketës së mbeturinave industriale 180 022 ton është sasia e materialeve të ricikluara në vitin 2020.

12.6 Raporte të qëndrueshmërisë janë publikuar nga Sharrcem për vitin 2020 dhe Shell Kosova për vitin 2021.

12.A Kapaciteti i instaluar për gjenerimin e energjisë së rinovueshme në Kosovë në vitin 2019 ka qenë 67964.8 MWh. Fatkeqësisht nuk ka të dhëna për vitin 2021.

12.C Subvencionet e lëndëve djegëse fosile si pjesë e PBB-së në vitin 2020 janë 1.02%.<sup>82</sup>

### Situata e përgjithshme

Industria prodhuese është një nga kategoritë më ndotëse dhe me më së shumti emetime të gazrave serrë sipas IPCC, duke mos përjashtuar edhe emetimet e drejtpërdrejta nga menaxhimi i tokës dhe menaxhimi i

plehut.<sup>83</sup> Sa i përket ndikimit të bujqësisë në ndotjen e tokave gjatë vitit 2019 AMMK ka mbledhur të dhëna nga institucione të ndryshme zyrtare në Kosovë. Rreth 805 ton agrokimikët importohen në Kosovë në formë insekticidesh, rodenticidesh, fungicidesh, herbicidesh, produkteve kundër rritjes dhe rregullatorët e rritjes së bimëve, dezinfektues dhe produkte të ngjashme. Ndërsa plehëra organike janë importuar 26,681 ton gjatë vitit 2019. Mbeturinat e rrezikshme nga agrokultura, hortikultura, kultura ujore, pylltaria, gjuetia dhe peshkimi të gjeneruara në 2019 janë 160.8 ton apo 0.1 % e totalit të mbeturinave të rrezikshme.


Niveli i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nuk është i kënaqshëm, sepse bazohet në një sistem shumë të paqëndrueshëm me nivel tejet të ulët të riciklimit. Ky sistem i menaxhimit të mbeturinave nuk ofron të dhëna për mbulueshmërinë, gjenerimin dhe trajtimin e mbeturinave dhe si pasojë është e vështirë të konstatohet gjendja aktuale. Bazuar në sasinë e mbeturinave të grumbulluar nga operatorë të licensuar, në Kosovë gjatë vitit 2020 janë gjeneruar mesatarisht 230.8 kg

<sup>82</sup> Të dhëna nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar përmes bazës së të dhënave globale të OZhQ-ve të Kombeve të Bashkuara. Të qasshme këtu:

[https://ourworldindata.org/grapher/fossil-fuel-subsidies-gdp?tab=chart&region=Europe&country=~OWID\\_KO](https://ourworldindata.org/grapher/fossil-fuel-subsidies-gdp?tab=chart&region=Europe&country=~OWID_KO)

<sup>83</sup> Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit 2020, AMMK

mbeturina për kokë banori. Komunitat janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve komunale siç janë mbledhja, transportimi dhe asgjësimin e mbeturinave.



Komuna e Prishtinës ka hartuar projektin për trajtimin e mbetjeve nga krasitjet dhe kositjet e hapësirave të gjelbëra, i cili ka për qëllim që nga këto mbetje të krijohet kompost i cili do të përdoret me

qëllim të plehërimit të hapësirave të gjelbëra. Projekti ka filluar në muajin nëntor 2019 dhe është në përfundim.<sup>84</sup> Përmirësim shihet edhe në reduktimin e numrit të deponive ilegale nga viti 2019 në vitin 2020 janë eliminuar 300 deponi të tilla. Prej 1189 deponive ilegale në vitin 2020, 0.3% janë deponi të mbeturinave të rrezikshme-industriale.<sup>85</sup>

Përmes Strategjisë (2021-2030) dhe Planit të Veprimit (2021-2023) për Menaxhim të Integruar të Mbeturinave në Kosovë trajtohen obligimet e Kosovës që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA-ja) dhe politikat sektoriale në fushën e menaxhimit të mbeturinave të përafërta me ato të BE-së, duke e përshtatur kështu legjislacionin e Kosovës me acquis e BE-së.

## Ligjet që përfshijnë këtë objektive



Ligji për produkte dhe paisje medicinale



Ligji për blegtorinë



Ligji për bujqësinë organike



Ligji për ushqimin

## Sfidat kryesore

- Kosova është afër shterjes së kapacitetit të deponive të saj. Për më tepër këto deponi ekzistuese nuk menaxhohen sipas standardeve dhe rregulloreve të BE-së.
- Për shkak të zgjerimit të shpejtë të industrisë së ndërtimit, mbeturinat e kësaj industrie po rriten me shpejtësi dhe ato po hidhen në mënyrë të paligjshme nëpër

<sup>84</sup> Raport vjetor për vitin 2020, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Komuna e Prishtinës. E qashme këtu: [https://prishtinaonline.com/uploads/dshpmsh\\_-\\_raporti\\_2020-](https://prishtinaonline.com/uploads/dshpmsh_-_raporti_2020-)

[19.03.2021\\_final.pdf?fbclid=IwAR1GVlW0iH2XL6uDb4hiKqx4RthPfr7AHjON012MPgPdW5SpdAv\\_chQT8](https://prishtinaonline.com/uploads/dshpmsh_-_raporti_2020-19.03.2021_final.pdf?fbclid=IwAR1GVlW0iH2XL6uDb4hiKqx4RthPfr7AHjON012MPgPdW5SpdAv_chQT8)

<sup>85</sup> Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2020, AMMK



toka bujqësore dhe në lumenjtë.

- Në Kosovë gjithashtu ka sasi të konsideruar të mbeturinave apo mbetjeve të kafshëve. Këto mbetje deponohen bashkë me mbeturina të tjera. Përgjegjëse për këto mbeturina është Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.
- Përveçse ka një nivel tejet të ultë të riciklimit në sistemin tonë të menaxhimit të mbeturinave, mungojnë edhe incentiva dhe politika për të motivuar bizneset dhe qytetarët për të ulur gjenerimin e mbeturinave ose riciklimin e tyre.

## Hapat e ardhshëm

- Zhvillimi i fushës së menaxhimit të mbeturinave, përkatësisht hapja e qendrave të reja të menaxhimit të mbeturinave.
- Draftimi i një ligji specifik për trajtimin e mbetjeve të kafshëve, në përputhje me normat e BE-së.
- Rritja e kapacitetit të nivelit lokal për trajtimin e mbeturinave të ndërtimit.
- Hapja e skemave të grumbullimit apo impianteve për çmontim të pajisjeve elektrike dhe elektronike, të cilat kërkojnë menaxhim të specializuar sepse këto mbeturina përmbajnë materiale të rrezikshme.



## OZHQ 13: VEPRIM PËR KLIMËN

*Ndërmarrja e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe efektet e saj*

### Vlerësimi i targeteve

13.1 Numri i vdekjeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në vitin 2019 ishte 103.<sup>86</sup> Gjithashtu, Strategjia për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020 është në përputhje me Kornizën Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015–2030.

13.2 Sa i përket masave për ndryshimet klimatike në Kosovë është miratuar Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019– 2028 dhe Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike 2019– 2021. Sipas matjeve emetimet vjetore të gazrave serrë në Kosovë për vitin 2020 janë vlerësuar rreth 9613 Gg (Giga gram) CO<sub>2</sub> eq, (equivalent) ose rreth 9.6 milion ton CO<sub>2</sub> eq.

### Situata e përgjithshme

Pozita gjeografike e Kosovës ia mundëson asaj të ketë një klimë të shumëllojshme. Tiparet e kësaj klime janë kryesisht me karakter mesdhetar dhe kontinental duke rezultuar me verë të ngrohtë dhe dimra të ftohtë me ndikime mesdhetare dhe alpine. Por si rezultat i ndryshimeve klimatike, këto karakteristika dita ditës po ndryshojnë. Klima pritet të bëhet më e thatë, me vera më të nxehta dhe përmbajtje më të shpeshta. Ndryshimet klimatike do të

kenë një ndikim të konsiderueshëm në jetën e qytetarëve. Rritja e temperaturave do të shkaktojë nxehtësi të papërbalueshme për disa grupmosha dhe kështu do të ketë një rritje të mortalitetit. Temperaturat priten të jenë më të larta në zonat urbane. Sipërfaqet e forta dhe të thata në zonat urbane – si çatitë, trotualet, rrugët, ndërtesat dhe parkingjet – ofrojnë më pak hije dhe lagështi sesa peizazhet natyrore dhe për këtë arsye kontribuojnë në temperatura më të larta.

Por, Modeli GAINS, i përdorur nga Komisioni Evropian në planifikimin e politikave klimatike si dhe International Futures me bazë në SHBA, mund të bëjnë vetëm parashikime gjenerale për klimën e Kosovës në të ardhmen, për shkak të mungesës së të dhënave të ndara historike statistikore.<sup>87</sup>


Sfidat me të cilat pritet të përballet Kosova si pasojë e ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike janë pjesë e trajtimit në Strategjia Për Ndryshimet Klimatike 2019– 2028 dhe **Plani i Veprimit Për Ndryshime Klimatike 2019– 2021**. Kjo strategji përcakton politikat për zvogëlimin e emisioneve të gazrave serrë (GS) dhe për përshtajtje me ndryshimet klimatike, si dhe jep rekomandime për masat që duhet të ndërmerren në këto dy fusha.

Emetimet e gazrave serrë për kokë


<sup>86</sup> Vdekjet e dhunshme sipas vitit, ASK.

<sup>87</sup> Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike 2019– 2021

banori janë relativisht më të ulëta në vendin tonë krahasuar me vendet e BE, rreth 5 ton CO2 ekuivalent, gjerësisht emetimet e gazrave serrë për njësi të BPV (0,5 kg CO2 ekuivalent) janë të larta.<sup>88</sup>



Nga figura e mëposhtme vërejmë se emetimin më të lartë të gazrave serrë e bënë sektori i energjisë. Kjo sepse Kosova burimin më të madh të energjisë elektrike e ka qymyrin, i cili liron sasi të mëdha të gazrave serrë.



89

Iniciativat për trajtimin e çështjeve që lidhen me klimën janë kryesisht nga sektori i OJQ-ve, sepse iniciativa të tilla në nivel kombëtar mungojnë. Përveç kësaj, niveli i përgjithshëm i ndërgjegjësimit publik për ndryshimet klimatike mbetet i ulët.

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë



Ligji për mbrojtjen e mjedisit



Ligji për energjinë



Ligji për eficiency të energjisë



Ligji për gazin natyror



Ligji për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve

## Sfidat kryesore

- Kosova nuk ka një legjislacion specifik që i adreson ndryshimet klimatike ose një strategji kombëtare specifike për këtë çështje.
- Të dhënat më të fundit nga monitorimi dhe raportimin për emetimin e gazrave

<sup>88</sup> Raporti vjetor i gjendjes së mjedisit, 2020, AMMK.

<sup>89</sup> Po aty

serrë mungojnë, pikë e cila është e nevojshme për implementimin e rregulloreve dhe ligjeve të BE-së për klimën.

- Përdorimi i madh i qymyrit si lëndë djegëse, qoftë për prodhim të energjisë në nivel shtetëror apo edhe për ngrohje, paraqet ndotësin kryesor të ajrit. Tranzicioni nga qymyri në burime të ripërtritshme të energjisë është kyç për të zvogëluar nivelin e dioksidit të karbonit.
- Problem shtesë në këtë pikë janë industritë të cilat punojnë me teknologji të vjetruara (veçanërisht Termocentralet).
- Ndërtimet dhe urbanizimi i pakontrolluar paraqet një problem shumë serioz në qytetet në të cilat po rritet numri i popullsisë. Ndërtimet pa leje në zona të rrezikshme si dhe mosrespektimi i standardeve të ndërtimit (p.sh. përdorimi i materialeve që shkaktojnë ndotje të lartë) po shkakton humbjen e shumë tokave bujqësore.
- Të gjitha këtyre sfidave iu shtohet në fund edhe ndërgjegjësimi i ulët i qytetarëve për ndikimet e veprimeve të tyre në degradim të ambientit.

## Hapat e ardhshëm

- Në të ardhmen duhet të themelohet një komision i veçantë për ndryshime klimatike.
- Hartimi i një strategjie për përgjigjen ndaj krizave natyrore është hap shumë i rëndësishëm në aspektin e mbrojtjes nga pasojat e ndryshimeve klimatike.
- Rritja e bashkëpunimit institucional (sidomos mes sektorit për energji dhe transport) për t'i koordinuar veprimet e tyre në lidhje me mbrojtjen e ambientit dhe klimës.
- Mbledhja dhe përditësimi i të dhënave nga ASK-ja në nivel kombëtar për emetimin e gazrave serrë si dhe hartimi i raporteve përkatëse.
- Zvogëlimi i përdorimit të qymyrit dhe rritja e përdorimit të burimeve të ripërtritshme, si dhe aplikimi i praktikës 'ndotësi paguan'.



## OZHQ 15: JETA NË TOKË

*Mbrojtja, rimëkëmbja dhe nxitja e shfrytëzimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, luftimi i shkretëzimit, ndalimi dhe prapësimi i procesit të degradimit të tokës, si dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.*

### Vlerësimi i targeteve

15.1 Kosova ka një sipërfaqe pyjore mjaft të madhe, saktësisht 44,70% në raport me sipërfaqen totale të tokës. Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë është 217 të cilat përfshijnë 11.53% e sipërfaqes së Kosovës.<sup>90</sup>

15.3 Fatkeqësisht niveli i degradimit të pyjeve në Kosovë është signifikant. Në vitin 2021 ka humbur 520ha sipërfaqe pyjore.<sup>91</sup>

15.4 Një pjesë e madhe e zonave malore në territorin e Kosovës janë të mbrojtura me ligj duke përfshirë Parkun Kombëtar "Sharri", Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", Rezervatin e Rreqebullit në Rusenicë, Rezervatin Maja a Arnenit, Rezervatin e Oshlakut, Rezervatin Pisha e Madh dhe Grykën e Rugovës.


15.5 Në mënyrë që të zvogëlohet degradimi i habitateve natyrore, në vitin 2013 është botuar "Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës", dhe

në vitin 2018 është botuar "Libri i Kuq i Faunes"

15.A Sipas Raportit vjetor për gjendjen e mjedisit nga AMMK, investime kapitale në mjedis për vitin 2020 kanë qenë rreth 66 milion euro.

### Situata e përgjithshme

Pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima, janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë një diversitet të pasur biologjik ku vlen të theksohet prania e llojeve relikte, endemike si dhe të llojeve me rëndësi të veçantë. Zonat më të pasura me florë dhe faunë janë "Malet e Sharrit" dhe



"Bjeshkët e Nemuna", por Kosova akoma

<sup>90</sup> Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit 2021, AMMK.

<sup>91</sup> Global Forest Watch. E qashme këtu: <https://www.globalforestwatch.org/map/country/X/KO/>

nuk ka një inventar të plotë të biodiversitetit. Deri tani në Kosovë janë inventarizuar rreth 1800 lloje të florës vaskulare, por për shkak të mungesës së të dhënave të plota, ky numër mund të jetë akoma më i madh. Krahasuar me sipërfaqen që ka Kosova, mund të themi se fitodiversiteti i Kosovës paraqet rreth 25 % të florës së Ballkanit dhe rreth 18 % të florës së Evropës.<sup>92</sup>

Lista e llojeve të bimëve që konsiderohen si të rralla dhe të rrezikuara në Kosovë përmban rreth 24 sosh<sup>93</sup>, por kjo listë akoma nuk është e kompletuar. Sipas Inventarizimit Nacional të Pyjeve në Kosovë të bërë në vitin 2021, sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve është 481,000 ha ose 47%. Një total 180,800 ha (38%) e pyjeve të Kosovës është klasifikuar si pronë private, dhe 295,200 ha (62%) është klasifikuar si pyje publike.<sup>94</sup> Në Kosovë ekzistojnë dy zona pyjore të cilat janë përcaktuar nga qeveria si parqe nacionale: Sharri në pjesën jugore dhe Bjeshkët e Nemuna në pjesën perëndimore të Kosovës. Këto dy parqe bëjnë pjesë në listën e zonave të mbrojtura. Në këtë listë poashtu bënë pjesë bifurkacioni i lumit Nerodime (nga viti 1979 është vënë nën mbrojtje ligjore si rezervat special i natyrës), rezervati i rreqebullit në Rusenicë, rezervati i Oshlakut, Gryka e Rugovës, trugu i rrapit në Marash, shpella e Radavcit, kanioni i Drinit të Bardhë, kanioni i Mirushës, shpella e Gadimes, etj. Gjatë vitit 2019 numrit të përgjithshëm të

zonave të mbrojtura u janë shtuar edhe 16 zona të reja të mbrojtura (15 monumente të natyrës dhe 1 peisazh i mbrojtur). Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë (2020) është 217 të cilat përfshijnë sipërfaqe prej : 125816.6 ha , ose 11.53% e sipërfaqes të Kosovës.<sup>95</sup>

Edhe pse Kosova ka sipërfaqe të konsiderueshme pyjore, ajo po zvogëlohet dita ditës si pasojë e aktiviteteve ilegale, zjarreve pyjore të shkaktuara nga njeriu, insekteve, zjarreve të shkaktuara nga temperaturat e larta, etj. Në vitin 2021 dëmi pyjor vlerësohet të jetë 520ha.<sup>96</sup> Ligji për Rregullimin e Tokës përcakton institucionet të cilat merren me rregullimin e tokës: komisioni për Rregullimin e Tokës; Ministria përkatëse, Agjencia Kadastrale e Kosovës, komuna dhe zyra kadastrale komunale. Në kuadër të Programit Mjedisor të Kosovës (PMK) financuar nga Qeveria Suedeze - SIDA, është realizuar projekti Inventarizimi i biodiversitetit përmes Librit të Kuq të Faunës, ku janë përfshirë gjithësej 306 lloje të shtazëve. Numri më i madh i llojeve të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Republikës së Kosovës i takon kategorive: Të dhëna të Pamjaftueshme (gjithsej 90) dhe Gati i Kërcënuar (gjithsej 80), kurse numri më i vogël i llojeve i takon kategorive: I Rrezikuar (24) dhe Skajshmërisht i Rrezikuar (25).

<sup>92</sup> Biodiversiteti i Kosovës, AMMK.

<sup>93</sup> Libri i Kuq i Faunës

<sup>94</sup> Raporti i Gjellbër 2021, MBPZHR

<sup>95</sup> Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit 2021

<sup>96</sup> Global Forest Watch

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë



Ligji për mbrojtjen e bimëve



Ligji për rregullimin e tokës



Ligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural



Ligji për gjuetinë



Ligji për mbrojtjen e varieteteve të bimëve

## Sfidat kryesore

- Mungesa e planifikimit të qartë për shfrytëzim të tokave nga ana e institucioneve lokale.
- Ndotja e tokave nga mbetjet industriale nga vrulli i madh i ndërtimeve, dhe mbeturinat të cilat nuk menaxhohen në mënyrë të rregullt.
- Shkalla e lartë e degradimit të tokave nga eksploatimi, ndërtimet dhe erozioni.
- Problem sfidues është edhe mos menaxhimi i ujërave të zeza dhe shkarkimet e ujërave të ndotura urbane dhe industriale.
- Mungesa e përvojës për shfrytëzim të qëndrueshëm të tokës nga komunat.
- Të dhëna të pamjaftueshme për numri e llojeve të florës dhe faunës së rrezikuar.
- Kapaciteti i vogël shkencor dhe profesional i institucioneve dhe OJQ-ve që kanë ekspertizë në fushën e mbrojtjes së biodiversitetit.

## Hapat e ardhshëm

- Fillimisht duhet të bëhet harmonizimi i plotë i legjislacionit nacional me Direktivat e BE-së dhe implementimi i tij.
- Rritja e aktiviteteve inspektuese dhe mbikqyrëse në sektorin e mbrojtjes së natyrës.
- Të hartohen politikat për zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e tokave.
- Të monitorohet përdorimi i pesticideve dhe fertilizereve në toka bujqësore.
- Të rritet numri i të dhënave për llojeve të rralla dhe të rrezikuara bimore dhe shtazore, përmes monitorimit të vazhdueshëm të gjendjes së tyre.



## OZHQ 16: PAQE, DREJTËSI DHE INSTITUCIONE TË FORTA

*Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet*

### Vlerësimi i targeteve

16.1 Numri i viktimave të vrasjeve me dashje për 100,000 banorë në vitin 2018 ishte 2.4.<sup>97</sup>

16.3 Të paraburgosurit e padënuar si përqindje e popullsisë së përgjithshme të burgjeve ishte 35.2% në vitin 2020 në Kosovë.<sup>98</sup>

16.5 Përqindja e bizneseve që kishin të paktën një kontakt me një zyrtar publik dhe që i dhanë ryshfet një zyrtari publik, ose iu kërkua ryshfet nga ata zyrtarë publik gjatë 12 muajve të mëparshëm ishte 3.2% në vitin 2019.<sup>99</sup>

16.6 Shpenzimet buxhetore të qeverisë ishin 119.2% në vitin 2022 në raport me buxhetin fillestar të miratuar.<sup>100</sup>

16.8 Kosova është anëtare në International Finance Corporation me 0.54% të anëtarëve, në International Bank for Reconstruction & Development me 0.53% dhe International Monetary Fund me 0.53% të anëtarëve.

16.10 Për të mundësuar mbrotjen e lirive themelore dhe qasjen në informacion Kosova ka miratuar Ligji nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike.

16.B Gjatë vitit 2020 nga një anketë ku qytetarët ishin pyetur "Në gjashtë muajt e fundit a ka pasur një situatë ku jeni ndjerë i diskriminuar", 33.3 % e të anketuarve të nacionalitetit serb dhe 11% e të anketuarve të nacionaliteteve të tjera jo-shqiptare deklaruan se kanë përjetuar situata të tilla.

### Situata e përgjithshme

Viti 2021 në Kosovë ka filluar me një jo stabilitet politik pas rënies së qeverisë në dhjetor të vitit 2020. Mirëpo gjatë vitit të fundit kjo situatë ka ndryshuar.

Kapitulli II i Kushtetutës së Kosovës është i tëri për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Këtu përfshihen të drejtat politike, civile, ekonomike, sociale, kulturore, etj. Për garantimin dhe zbatimin e këtyre të drejtave kërkohen institucione stabile dhe funksionale. Për këtë arsye dy nga katër

<sup>97</sup> World Development Indicators, Banka Botërore. E qasshme këtu: <https://databank.worldbank.org/reports.aspx?dsid=2&series=VC.IHR.PSRC.P5>

<sup>98</sup> Të dhënat nga burime të shumta të përpiluara nga OKB. E qasshme këtu: <https://ourworldindata.org/grapher/unsentenced-detainees-as-proportion-of-prison->

[population?tab=chart&region=Europe&country=-OW\\_ID\\_KOS](https://databank.worldbank.org/reports.aspx?tab=chart&region=Europe&country=-OW_ID_KOS)

<sup>99</sup> World Development Indicators, Banka Botërore. E qasshme këtu: <https://databank.worldbank.org/reports.aspx?dsid=2&series=IC.FRM.BRIB.ZS>

<sup>100</sup> Ligji mbi Ndarjen Buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës 2022



shtyllat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim janë qeverisja e mirë dhe siguria sundimi i ligjit. Strategjia e shih element kyç funksionimin e mirëfilltë të institucioneve për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm. Hapat për të bërë progres në këtë drejtim kanë qenë pjesë e planeve të secilës qeveri.

Përgjatë viteve numri i rasteve të viktimave të vetëvrasjeve ka pasur ulje dhe ngritje. Gjatë vitit 2019 ky numër ishte 39, krahasuar me vitin paraprak ku ky numër ishte 27.<sup>101</sup>

Në Kosovë ekziston një infrastrukturë ligjore e cila e dënon dhunën në familje. Për herë të parë mbrojtja nga dhuna në familje është rregulluar me Rregulloren nr.2003/12, të datës 07.05.2003, për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, fenomen të cilin më parë e ka trajtuar Kodi Penal i Kosovës dhe po ashtu edhe Ligji mbi Familjen. Përveç kësaj ekziston edhe një organ i veçantë që merret specifikisht me rastet e dhunës në familje.

#### **Zyra për Mbrojtje dhe Ndhim Viktimave.**

Kjo zyrë është organ i pavarur brenda Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe misioni i saj është është *“ofrimi i shërbimeve për viktimat e krimit gjatë procedurave ligjore dhe përfaqësimi i interesave të tyre në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë”*.

Iniciativa për Projekt Strategjinë për Sundimin e Ligjit është e para në llojin e saj. Projekt Strategjia është finalizuar dhe është miratuar nga Qeveria me datën 11 gusht 2021 dhe zbatimi i saj skadon në vitin 2026, pra është miratuar për një periudhë 5 vjeçare. Hartimi i

kësaj Strategjie është paraparë në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë, Planin e Dokumenteve Strategjike, Agjendën për Reforma Evropiane dhe Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA-së. Kjo Strategji synon ta rrisë transparencën e institucionve të Kosovës dhe kështu ta rikthejë besimin e qytetarëve në këto institucione. Sipas Transparency International në vitin 2021, pikët e Kosovës për korrupsionin janë 39/100 (sa më shumë pikë, aq më transparent është vendi). Nga 180



vende, Kosova rradhitet e 87 (sa më lartë në këtë rank, aq më transparent është vendi).<sup>102</sup>


**Ligji kundër Korrupsionit** ju garanton personave që parandalojnë, zbulojnë apo hetojnë korrupsionin gëzojnë pavarësi të plotë për qëllime të ushtrimit me efektivitet të kompetencave dhe përmbushjes së detyrimeve të tyre. Me anë të këtij ligji themelohet edhe Agjensioni Kosovar kundër korrupsionit si organ i pavarur.

**Ligj për qasje në dokumente publike** garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim, për të pasur qasje në dokumente publike, si dhe të drejtën për ripërdorimin e atyre dokumenteve.

<sup>101</sup> Vdekjet e dhunshme sipas vitit, ASK.

<sup>102</sup> Të dhënat shtetërore, Transparency International. E qasshme këtu: <https://www.transparency.org/en/countries/kosovo>

## Ligjet që përfshijnë këtë qëllim



Kodi Penal i Kosovës



Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



Ligji për Amnestinë



Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale



Ligji për Avokatin e Popullit

## Sfidat kryesore

- Ndër sfidat më të mëdha janë vonesat në sistemin gjyqsor dhe prokurorial, ku faktori kryesor është alokim jo i duhur i burimeve njerëzore në raport me ngarkesën e lëndëve në gjykata.
- Në anën tjetër kemi llogaridhënie të pamjaftueshme të punonjësve në institucione;
- Trajnimi i gjyqëtarëve dhe prokurorëve nuk është i detyrueshëm për ta, përveç se në rastet kur kanë vlerësim të ulët të performancës.
- Qasje e ulët për grupet e marginalizuara në institucionet e drejtësisë.
- Implementimi jo adekuat i ligjeve që garantojnë të drejtat dhe liritë e qytetarit.
- Evazioni fiskal, mashtrimet tatimore dhe ekonomia e zezë.
- Mungesa e kontrollit të integritetit (*vetting*), ku duhet të ketë verifikim fillestar dhe kontrollim të vazhdueshëm të integritetit.

## Hapat e ardhshëm

- Refroma të vazhdueshme në sistemin gjyqsor sa i përket kapaciteve njerëzore dhe teknike të gjykatave.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive mbi ekzistencën e Strategjisë kundër Korrupsionit.
- Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i institucioneve përkatëse, sidomos i atyre të sistemit gjyqsor.
- Të rritet numri i rasteve penale të cilat trajtojnë korrupsionin dhe krimet e tjera financiare.
- Të rritet bashkëpunimi mes Ministrisë së Drejtësisë, Agjencisë kundër Korrupsionit, Njësisë së Inteligjencës Financiare, Administratës Tatimore dhe zyrtarëve të doganave.



## OZHQ 17: PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT

*Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm*

### Vlerësimi i targeteve

17.1 Të hyrat buxhetore për vitin 2022 ishin 2,430 milionë EURO, prej të cilave 89.24% vijnë nga të hyrat tatimore.

17.2 Ndhima zyrtare neto për zhvillim, totale dhe për vendet më pak të zhvilluara, si përqindje e të ardhurave kombëtare bruto të donatorëve (GNI) të Komitetit të Ndhmës Zhvillimore të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) ishte 0.33%.<sup>103</sup>

17.3 Sa i përket mbështetjes financiare për vendin tonë, niveli i investimeve të huaja direkte si përqindje e buxhetit ishte 0.9%<sup>104</sup>, kurse remitancat përfshijnë 15.4% të PBB Reale.<sup>105</sup>

17.4 Shërbimi i borxhit si pjesë e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2020 ishte -5.34%.<sup>106</sup>

17.8 Për të përmirësuar përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ASK bënë matje të përdorimit të internetit dhe në vitin 2022 ka rezultuar se 79% e individëve janë përdorues të internetit.

17.13 Ka shumë variabla që mund të përfshihen në panelin makroekonomik, mirëpo për Kosovën ka të dhëna vetëm për inflacionin vjetor të çmimeve të konsumit. ASK tregon se norma vjetore e inflacionit e matur në muajin gusht 2022 krahasuar me muajin gusht të vitit 2021 ishte 13 për qind më i lartë.

17.18 Ligji nr. 04/I-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës është legjislacion kombëtar statistikor që përputhet me Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare.

### Situata e përgjithshme

Që nga shpallja e pavarësisë, Republika e Kosovës vazhdimisht synon që të ndërtojë marrëdhëniet e saj bilaterale dhe multilaterale me aktorë të ndryshëm të sistemit ndërkombëtar. Kosova tashëm është bërë pjesë e disa organizatave të rëndësishme botërore si: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, Federata Botërore e Futbollit, Federata Evropiane e Futbollit, Komiteti Olimpik, Organizata Botërore e Doganave dhe Marrëveshja për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore

<sup>103</sup> Official Development Assistance 2021. E qasshme këtu: <https://www.oecd.org/dac/financing-sustainable-development/development-finance-standards/official-development-assistance.htm>

<sup>104</sup> Investimet e huaja direkte 2008-2020, Banka Botërore. E qasshme këtu: [https://ourworldindata.org/grapher/foreign-direct-investment-net-outflows-of-gdp?tab=chart&region=Europe&country=-OWID\\_KOS](https://ourworldindata.org/grapher/foreign-direct-investment-net-outflows-of-gdp?tab=chart&region=Europe&country=-OWID_KOS)

<sup>105</sup> Ekonomia e Kosovës, BQK. E qasshme këtu:

<https://bqk-kos.org/eag/sq/>

<sup>106</sup> Borxhi si pjesë e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, 2004-2020, Banka Botërore. E qasshme këtu: [https://ourworldindata.org/grapher/debt-service-of-exports-of-goods-services?tab=chart&region=Europe&country=-OWID\\_KOS](https://ourworldindata.org/grapher/debt-service-of-exports-of-goods-services?tab=chart&region=Europe&country=-OWID_KOS)

(CEFTA). Gjithashtu ka marrëdhënie të mira edhe me disa organizata të tjera ku nuk është anëtare, si p.sh. OKB, BE, OECD, WHO, WTO, etj.

Gjatë dekadës së fundit prioriteti kryesor politik i shtetit ka qenë antarësimi në Bashkimin Evropian. Çështja e perspektivës së Kosovës për antarësim në BE (dhe OKB) është ringjallur me nisjen e dialogut politik me Serbinë në vitin 2012. Nënshkrimi në vitin 2013 i Marrëveshjes së Prillit i ka paraprirë nënshkrimin të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe BE-së. Por që nga atëherë Kosova nuk ka pasur ndonjë progres të dukshëm në arritjen e qëllimit të antarësimit.

Rruga e Kosovës drejt antarësimit në OKB dhe BE është bllokuar nga dy anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe pesë shteteve anëtare të BE-së.<sup>107</sup> Arritja e dialogut politik me Serbinë është hapi i radhës që e shtyn Kosovën në rrugën e saj drejt antarësimit. Kjo për arsye se bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira me fqinjët janë parakusht për hyrjen në BE.

Marrëdhëniet e mira me fqinjët nënkupton intensifikimin e tregtisë,

inkurajimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe ideve, dhe bashkëpunimin drejtë arritjes së synimeve të përbashkëta. Kosova është pjesëmarrëse në disa iniciativa rajonale. Në vitin 2014, në Samitin e Bukureshtit Kosova u bë pjesëmarrëse në **Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP)**. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj iniciative është forcimi i sigurisë, stabilitetit dhe përparimit ekonomik të rajonit të Evropës Juglindore. Iniciativat tjera në të cilat është pjesëmarrëse Kosova janë: Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Iniciativa Rajonale për Migrimit, Azil dhe Refugjatë (MARRI), Fondi për Ballkanin Perëndimor (WBF), Zyra e Bashkëpunimit Rajonal për të Rinjtë (RYCO) dhe Procesi i Berlinit. Viteve të fundit Kosova është bërë pjesë e iniciativës së OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm. Diskutimet për këtë iniciativë në Kosovë kanë filluar gjatë vitit 2015, me ndihmën e OKB-së. Gjatë vitit 2018, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Rezolutën për OZHQ-të si dhe ka themeluar Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm. Gjithashtu janë bërë lidhjet mes OZHQ-ve dhe strategjive të tjera sektoriale, ku deri më sot janë harmonizuar 25 nga 50 strategjitë prioritare qeveritare.

## Sfidat kryesore

- Paralelisht me përpjekjet e saj për antarësim në BE, Kosova është duke u përpjekur për përfundimin e legjislacionit me OZHQ-të. Raporti Kombëtar Vullnetar do të shërbejë si bazë për të informuar dhe përcaktuar reformat e kornizave ligjore dhe politikave në përfundim me indikatorët e OZHQ-ve. Në këtë kontekst është e nevojshme që të krijohet një databazë specifike për OZHQ-të, që të monitorohet progresi i tyre dhe hapsirat se ku ka ngecje. Mungesa e të dhënave

---

<sup>107</sup> Rruga e Kosovës drejt antarësimit në BE dhe OKB, KFOS

rezulton në moskoherencë mes politikave publike, OZHQ-ve dhe planifikimit buxhetor për implementimin e këtyre të fundit.

## Hapat e ardhshëm

- Përpilimi i programeve të reja të bashkëpunimit me UNICEF dhe UNDP;
- Pjesëmarrja në aktivitete humanitare dhe të sigurisë ndërkombëtare;
- Përforcimi i kapaciteve në lidhje me tregtinë ndërkombëtare;
- Vazhdim i përpjekjeve për bashkëpunim me shtetet e rajonit;

## Harta e Aktorëve të Zhvillimit të Qëndrueshëm

<i>Akterët</i>	Lloji p.sh. institucional (lokale/qëndrore), jo-institucional (biznes/donator/OJQ), internacional	Roli
<i>Ministria e Shëndetësisë</i>	Qëndrore	Krijon politika, koordinon aktivitetet dhe zbaton ligjet e një sistemi të kujdesit shëndetësor jodiskriminues dhe të përgjegjshëm;
<i>Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit</i>	Qëndrore	Planifikimi dhe mbikëqyrja e zhvillimit të sistemit të arsimit të lartë dhe shkencës;
<i>Ministria e Zhvillimit Rajonal</i>	Qëndrore	Hartimi i politikave publike dhe akteve ligjore, miratimi i aktet nënligjore dhe vendosjen e standardeve të detyrueshme në fushën e zhvillimit rajonal dhe zbatimin e tyre;
<i>Ministria e Ekonomisë</i>	Qëndrore	Harton dhe zbaton politika që nxisin rritjen dhe stabilitetin ekonomik, mundësojnë zhvillimin e biznesit vendas, inkurajojnë bashkëpunimin ekonomik për tërheqjen e investimeve të huaja;
<i>Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve</i>	Qëndrore	Ka përgjegjësi të përgjithshme për zhvillimin e kornizës së politikave fiskale dhe ekonomike të Qeverisë; mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave publike dhe duke luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik të vendit;

<i>"Deputetët e Gjelbër"</i>	Qëndrore	Synon të përfshijë Kuvendin e Kosovës në një rol më aktiv për të siguruar formësimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit publik, i cili merr parasysh perspektivën e ndikimit në mjedis;
<i>Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm</i>	Qëndrore	Synon monitorimin dhe ndihmën në arritjen e objektivave të zhvillimit, të njohur si Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ);
<i>Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione</i>		Shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut, monitorimin dhe zbatimin e parimit të barazisë gjinore në legjislacionin dhe peticionet e paraqitura nga një ose më shumë qytetarë;
<i>Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit</i>	Qëndrore	Është përgjegjës për rregullimin e aktiviteteve të ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë;
<i>Zyra e Rregullatorit të Energjisë</i>	Qëndrore	Ka për detyrë të rregullojë aktivitetet në Sektorin e Energjisë në Kosovë, duke përfshirë energjinë elektrike, ngrohjen qendrore dhe gazin, në përputhje me obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë;
<i>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</i>	Qëndrore	Sigurimi i drejtimit të politikave në zhvillimin e infrastrukturës së ndërtuar cilësore; dhe promovimi i një jetese dinjitoze nga njëra anë dhe krijimi i një mjedisi të pastër, të shëndetshëm dhe të mbrojtur mirë që mbështet një shoqëri dhe ekonomi të qëndrueshme nga ana tjetër;

<i>State Aid Commission</i>	Qëndrore	Përgjegjës për dhënien e ndihmës shtetërore, e cila konsiderohet çdo shpenzim aktual, i mundshëm ose reduktim i të ardhurave shtetërore, të dhëna në çfarëdo forme nga koncensiondhënësi ose që mund t'i atribuohet shtetit, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar disa përfitues të ndihmës shtetërore ose produkte të mallrave të caktuara. dhe shërbime, dhe që është në kundërshtim me obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës;
<i>Kostt</i>	Qëndrore	Si operator tregu, ai është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregtisë së energjisë elektrike;
<i>Autoriteti Kosovar i Konkurrencës</i>	Qëndrore	Të zhvillojë aktivitete në krijimin e kushteve që tregjet të ofrojnë më shumë përfitime për konsumatorët, bizneset dhe shoqërinë në tërësi, duke mbrojtur konkurrencën në treg dhe duke promovuar kulturën e konkurrencës në Kosovë;
<i>Zyra Kombëtare e Auditimit</i>	Qëndrore	Për të përmirësuar qeverisjen e sektorit publik në dobi të qytetarëve dhe nëpërmjet auditimeve cilësore për të forcuar përgjegjshmërinë e administratës publike për një përdorim efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare;



<i>The Kosova Humanitarian and Charitable Society- Mother Teresa</i>	OJQ	Qëllimi i mbështetjes së familjeve të cënueshme të situatës socio-ekonomike të krijuara në Kosovë, për shkak të masave diskriminuese të zbatuara ndaj shqiptarëve nga regjimi i vitit 1999;
<i>Banimi Social dhe të Drejtat Pronësore në Kosovë</i>	OJQ	Identifikon individët ose familjet që kanë nevojë për strehim social dhe për t'i ndihmuar ata të fitojnë strehim social dhe të ofrojnë ndihmë ligjore në çështjet që lidhen me strehimin social dhe të drejtat pronësore;
<i>Qendra për Informim dhe Përmirësim Social</i>	OJQ	Rritja e ndërgjegjësimit dhe gjetja e zgjidhjeve për problemet që prekin popullatën nga perspektiva sociale;
<i>Instituti i Kosovës për Trajnime</i>	OJQ	Ofron trajnime juridike;
<i>Qendra për Arsim e Kosovës</i>	OJQ	Trajnimi i stafit të shkollës, në lidhje me metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe udhëheqjes;
<i>Society for Education and Entrepreneurship Development (SEED)</i>	OJQ	Avancimi i arsimit, promovimi i sipërmarrjes, institucionalizimi i edukimit financiar, zgjerimi i mundësive ekonomike;
<i>TOKA</i>	OJQ	Ofron programe arsimore inovative për të rinjtë;
<i>Qendra për Shërbime Humane dhe Zhvillim</i>	OJQ	Zhvillimi i strategjive dhe produkteve unike që forcojnë, aktivizojnë dhe fuqizojnë qytetarët tanë përmes projekteve, trajnimeve, vlerësimeve, kërkimeve, aktiviteteve humanitare, projekteve të infrastrukturës dhe bashkëpunim me organizata të tjera;

<i>EcoKosWomen</i>	OJQ	Trajtimi i problemeve komplekse për të krijuar një mjedis më të favorshëm socio-ekonomik, duke përfshirë të drejtat e grave, punën për pabarazinë gjinore dhe sigurimin e edukimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në një mjedis eko për të gjitha komunitetet;
<i>Rrjeti i Grave të Kosovës</i>	OJQ	Mbështetja, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të grave dhe vajzave në Kosovë;
<i>Community Development Initiatives</i>	OJQ	Furnizimi me ujë të pijshëm dhe ujëra të zeza;
<i>Shoqata e Ujësjiellësve dhe Kanalizimeve të Kosovës</i>	OJQ	Të veprojë si një lidhje ndërmjet anëtarëve të saj për të zhvilluar, promovuar dhe mbrojtur interesat e përbashkëta të sektorit të ujësjiellësit dhe ujërave të zeza, drejt krijimit të një sektori financiarisht të qëndrueshëm, i aftë për të çuar përpara themelet e përgjithshme në fushën e punës së tyre;
<i>Shoqata për Energji të Ripërtëritshme e Kosovës</i>	OJQ	Përfaqëson interesat e ndërmarrjeve që janë aktive në të gjithë spektrin e energjisë së rinovueshme, duke përfshirë energjinë elektrike, ngrohjen dhe karburantet;
<i>CEAE - Qendra për Mjedis dhe Energji Alternative</i>	OJQ	Ka një mision të promovojë mirëkuptimin dhe veprimin e nevojshëm për një mjedis të qëndrueshëm në nivel kombëtar nëpërmjet kërkimeve, planifikimeve dhe veprimeve konkrete në terren;

<i>KSCF</i>	OJQ	Fuqizimi i shoqërisë civile përmes granteve të shoqërisë civile, ngritjes së kapaciteteve dhe avokimit për mbrojtjen e hapësirës për qytetari aktive;
<i>Innovation Foundation Kosovo</i>	OJQ	E vendos inovacionin si prioritet në jetën publike dhe private në Kosovë, si vendore dhe nivel kombëtar, me fokus për të mbështetur, stimuluar, inkurajuar, promovuar, edukuar, zhvilluar inovacione në Kosovë në të gjitha fushat e fushave sociale dhe ekonomike, për të zhvilluar dhe përmirësuar burimet njerëzore dhe udhëheqjen e aftë që do të veprojnë si bazë për zhvillimin e mëtutjeshëm të zhvillimit njerëzor dhe ekonomik të Kosovës, për të avancuar konkurrencën e vendit tonë krahas vendeve të zhvilluara.
<i>Iniciativa për Progres- IPO</i>	OJQ	Të promovojë pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore;
<i>Network of Peace Movement</i>	OJQ	Promovimi i paqes, shmangia e diskriminimit etnik në mënyrë që të krijohet një mjedis tolerant dhe demokratik në Kosovë;
<i>REC - Reconciliation Empowering Communities</i>	OJQ	Promovon zhvillimin e shoqërisë kosovare, duke angazhuar potencialin njerëzor në mesin e komuniteteve të ndryshme;
<i>Endemika</i>	OJQ	Ndihmon në mbrojtjen e mjedisit përmes aktiviteteve dhe veprimeve të ndryshme;
<i>Local Peace</i>	OJQ	Fuqizimi i njerëzve të zakonshëm për të marrë rol aktiv në procesin e ndërtimit

		të paqes dhe pajtimit;
<i>Balkans Policy Research Group</i>	OJQ	Një think-tank që punon për Konsolidimin Institucional dhe Demokratik, Rajonal Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet e Mirë Fqinjësisë, Reformat dhe Integrimi në BE në Ballkanin Perëndimor;
<i>Kosova Democratic Institute / Transparency International Kosova</i>	OJQ	Mbështet zhvillimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe luftën kundër korrupsionin duke promovuar transparencën, llogaridhënien dhe integritetin në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

Ky projekt financohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).